



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar auditimi financiar dhe përputhshmërie në
Bashkinë Fushë Arrëz

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË
PËRPUTHSHMËRISË
NË
BASHKINË FUSHË ARRËZ

Janar 2024

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-10
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II.	HYRJA	
II.1.	Objekti i auditimit	10-14
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	14-82
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14-16
III.2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	16-82
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	16-18
III.2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	18-20
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	21-36
III.2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2022	36-53
III.2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik	53-76
III.2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	76-78
III.2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)	78-78
III.2.7	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	79-82
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	83-90

Shkurtime

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
DRT	Drejtoria Rajonale Tatimore
DSHP	Drejtoria e Shërbimit Pyjor
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Aksionare
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
STTV	Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
TNI	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ZK	Zonë Kadastrale

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar dhe përputhshmëri në Bashkinë Fushë Arrëz, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, planifikimit, realizimit të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave të lidhura për punë publike, planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, si dhe aktivitetin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit. Gjithashtu pjesë e këtij auditimi ishte edhe trajtimi i ankesë të administruar në KLSH me numër 798 prot. Datë 19.09.2023 si dhe marrë shkas nga kjo ankesë edhe largimet dhe rekrutimet e reja pranë Bashkisë Fushë Arrëz.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 13.10.2023 deri në datën 13.11.2023 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të Bashkisë Fushë Arrëz” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 8 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikime. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

-Për projekt raportin e auditimit nga subjekti i audituar me shkresën nr.871/9 prot., datë 18.12.2023, janë paraqitur observacione, të cilat janë trajtuar rast pas rasti në çështjet përkatëse.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim rezultoi se nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua se në:

-4 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj), si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjestim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

-1 raste OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit.

-3 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar dhe dokumentaur mënyra e përlogaritjes së fondit limit .

-Veç sa më sipër, u konstatua se kërkesat për karburant nga sektorë të ndryshëm në Bashkinë Fushë Arrëz, nuk argumentohen në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu për mjete të ndryshme nuk është përcaktuar norma e konsumit të karburantit, si p.sh., mjetet e sektorit të zjarrëfikses.

Gjithashtu nga auditimi i:

-Veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezulton se në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka asnjë evidencë nga punonjës të bashkisë për veprimtari që mbulojnë fushën e inspektimit dhe kontrollit të territorit.

-Të dhënave të siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me leje minerare sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë vitit 2022, në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, kanë ushtuar aktivitet në sektorin e kërkimit, zbulimit, prodhimit të

minerareve 10 subjekte me sipërfaqe 11.475 km², për të cilat NSHP Bashkia Fushë Arrëz nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj)¹.

-Debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz, rezulton se për vitin 2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe ato familjare në vlerën 3,572,456 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz. Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Fushë Arrëz, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve debitore dhe nuk ka kryer asnjë procedurë tjetër, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo.

-Dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve, u konstatua se në Bashkinë Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimor 2022, ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 4 subjekte nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar, të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 4,000,000 lekë, vlerë që konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

-Kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Fushë Arrëz me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Fushë Arrëz, përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe moveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz në 1,761,248 lekë.

-Raportimit të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2022, ka rezultuar kontabilizimi jo i saktë dhe i drejtë për:

Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2022 është në vlerën 283,626,978 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 284,293,539 lekë, pra me një rritje të vlerës së debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 999,561 lekë.

-Llogaria nr.470 “Llogari në pritje - të ardhura për tu marrë” paraqitet me gjendje 284,293,539 lekë në fund të vitit 2022 që lidhet me llogarinë e debitorëve nr.468.

Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet me gjendje në shumën 11,451,697 lekë në fund të vitit 2021, ndërsa për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën 17,700,894 lekë me një rritje prej 6,249,197 lekë.

-Gjendjet e llogarive 421 “Personeli e llogari të lidhura me to”, në mbyllje të vitit 2022 është në shumën 8,877,919 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2022, ndërsa shuma prej 4,585,803 janë detyrime të prapambetura për paga për persona të larguar nga puna.

I.2. Në mënyrë të përmblendhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Fushë Arrëz dhe Njësitë Administrative nuk janë	21-36	E Lartë	Zyra e Shërbimeve Publike të marrë masa për pajisjen me autorizimet përkatëse të të gjithë subjekteve që operojnë në fushën e tregëtimit të hidrokarbureve dhe pas plotësimit të dosjeve përkatëse me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të rakordojë me zyrën e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për përlllogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve nga pajisja me autorizime.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	lëshuar autorizimet përkatës për ushtrimin e aktivitetit. Si pasojë e mos rakordimit nga zyra e Shërbimeve Publike, të 4 subjektet që operojnë në fushën e tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre, nuk janë pajisur me autorizim 5 vjecar dhe rrjedhimisht të gjithë rezultojnë debitorë në vlerën totale 4,000,000 lekë.			
2	Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëon të drejtat e Bashkisë Fushë Arrëz për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 3,572,456 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën prej: -3,572,456 lekë detyrimi i nga subjektet private dhe debitorë për qiratë. -99,859 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes dhe institucione	36-53	E mesme	Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.
3	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 4 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj), si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.	53-76	E Lartë	Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.
4	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 3 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar dhe dokumentaur mënyra e përlllogaritjes së fondit limit . Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.	53-76	E Lartë	Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa që në çdo rast në përlllogaritje fondit limit ti nënshtrohen njëres nga mëqë parashikon ligji si dhe për çdo rast të marrin masat për dokumentimin e tij me qëllim menjanimin e problematikave të krijuara dhe menaxhimin e me efijencë të fondeve publike.
5	Nga auditimi I procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburanti Diesel për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2022”, me fond limit 6,720,000 lekë pa tvsh u konstatua se nga KVO është kualifikuar OE “D...” ShPK me disa mangësi për sa i përket kriterëve për kualifikim.	53-76	E Lartë	Bashkinë Fushë Arrëz, Komisioni I Vlerësimit të ofertave të marrin masa për kualifikimin vetëm të atyre OE që plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe në çdo rast për çdo paqartësi apo pasaktësi tëërkojnë shpjegime shitesë nga OE pjesmarrës me qëllim përfitimin e punës/shërbimit apomallit me cilësinë dhe çmimin më të mirë.
6	Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 1 rast për lejen me objekt ““Ndërtimi i KUL -Faza e Parë mbi Damben e Vjetër të Sterileve pranë Fabrikës së Pasurimit Bakrit Fushe Arrëz”, personat përgjegjës që administrojnë procesin në sistemin “ me zhvillues subjektim “B...” shpk, Subjekti aplikues, nuk ka paraqitur mendim nga asnjë prej	76-78	E Lartë	Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Fushë Arrëz, të marra masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, ku të respektohet legjislacioni sektorial në fuqi, duke kryer bashkëveprimin me të gjitha institucionet e ngarkuara për dhënia mendimi, përpara miratimit të lejes.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	institucioneve të nevojshme për miratimin e lejeve të ndërtimit			
7	Nga auditimi për veprimtarinë e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezulton se në Bashkinë Fushë Arrëz për periudhën 01.01.2022 -31.12.2022, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), nuk është ngritur dhe nuk funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Për vitin 2022, sipas strukturës të miratuar me urdhrin nr. 459, datë 13.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, të Njësi Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2022” është përcaktuar një pozicion pune si inspektor i mbrojtjes së territorit, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve, pranë Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Investimeve. Sa më sipër, përgjatë vitit nuk është konstatuar asnjë ndërtim pa leje.	78-78	E Mesme	Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.
8	Nga të dhënat rezulton se Bashkia Fushë Arrëz ka patur detyrime të prapambetura në fillim të vitit 2022 në vlerën 8,778,833 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime në vlerën 1,630,601 lekë dhe janë kryer pagesa në vlerën 5,024,849 lekë, duke mbartur një detyrim të prapambetur në fund të 2022 në vlerën 5,384,585 lekë. Nga auditimi rezulton se e gjithë vlera e detyrimeve të prapambetura përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore për largimet e pa drejta nga puna të punonjësve, si dhe nga vendimet gjyqësore mbi shkelje që lidhen me projektet e investimeve. Vetëm për vitin 2022 janë krijuar detyrime nga largimet e pa drejta nga puna në vlerën 1,630,601 lekë, të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë.	36-53	E Lartë	Titullari i Bashkisë në bashkëpunim me njësinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për vlerësime dhe vendimarrje korrekte në rastet e largimeve nga puna të punonjësve, duke argumentuar në çdo rast shkeljet e konstatuara, si dhe pas ndjekies me përpikmëri të çdo faze që parashikon kuadri ligjor përpara vendimarrjes finale për shkarkimin e punonjësit.
9	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2022” me fond limit 1,768,302 - lekë pa tvsh u konstatua se NJP në përlllogaritjen e fondit limit nuk ka respektuar format që parashikohet në legjislacion gjithashtu nuk kanë dokumentuar mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit në kundërshtim me parshikimet ligjore, duke sjellë një rritje të kostos për dru zjarri me vlerë 540,540 lekë më tepër, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.	53-76	E Lartë	Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa që në çdo rast në përlllogaritje fondit limit ti nënshtrohen njëres nga mëqë parashikon ligji si dhe për çdo rast të marrin masat për dokumentimin e tij me qëllim menjanimin e problematikave të krijuara dhe menaxhimin e me efikasitet të fondeve publike.
10	Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Fushë Arrëz me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Fushë Arrëz, përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe moveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e	23-52	E Mesme	Zyra e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me zyrën Juridike, të marrin masa që për aq sa është e mundur të identifikohet, të filloje procedura e marrjes së masave shtrënguese për vjeljen e të ardhurave të munguara, nëpërmjet parashikimeve ligjore në fuqi.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 1,761,248 lekë kryesisht nga mos pagesa e detyrimeve kontraktuale.			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

Opinionimi mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Fushë Arrëz për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200², pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, **shprehim një opinion të modifikuar**³ për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Fushë Arrëz, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin e modifikuar.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Fushë Arrëz, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 3,003 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin vlerën e tyre reale, si vijon:

- Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm” është pasqyruar më pak për vlerën 3,671,456 lekë;
- Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar më shumë për vlerën 9,250,997 lekë;

Opinionimi i auditimit mbi përputhshmërinë

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit *Bashkinë Fushë Arrëz*, bazuar në analizën e riskut⁴, janë konstatuar disa anomali në vendosjen

² Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve nga auditimi.

³ Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

⁴ ISSAI 4000.52. Audituesit duhet të marrin parasysh riskun e auditimit gjatë procesit të auditimit.

e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë të plotësuar, që janë baza për dhënien e një opinionit të kualifikuar⁵.

Për drejtimin e Bashkisë Fushë Arrëz

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit Financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Opinion i kualifikuar:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Fushë Arrëz, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Fushë Arrëz, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Përshkrimi i çështjeve:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se është konstatuar përdorim i fondeve publike jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit, për:

- 1 rast në procedurat e prokurimit publik në vlerën 540 mijë lekë;
- 3,572 mijë lekë të ardhura të munguara nga marrëdhëniet kontraktore me subjektet që kanë shfrytëzuar fondin pyjor/kullosor.
- 1,109 mijë lekë për 131 subjekte, të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifën vendore;
- 4,000 mijë lekë për 4 subjekte, të cilët nuk kanë paguar detyrimin për licencimin e ushtrimit të aktivitetit në tregtimin e karburantit;

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Fushë Arrëz.

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Fushë Arrëz, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të fushës.

⁵ Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë material në krahasim me kriteret e aplikuara, por jo të përhapura.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 871/1 datë 10.10.2023 prot., të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Fushë Arrëz nga data 13.10.2023 deri në datën 13.11.2023, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”, i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1.S. H., Auditues, Përgjegjës Grupi.
- 2.G. P., Auditues, Anëtar.
- 3.J. K., Auditues, Anëtar.
- 4.R. K., Auditues, Anëtar.

II.1. Objektivi i auditimit.

-Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

-Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbimeve të investimeve, planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

II.2. Qëllimi i auditimit.

-Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

-Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi

lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara, miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe kontrollin e territorit për ndërtimin e objekteve pajisur me leje zhvillimi dhe ndërtimi, ose deklarata paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, për periudhën objekt auditimi.

-Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

II.3. Identifikimi i çështjes.

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar;
5. Planifikimi, realizimi i prokurimeve dhe zbatimi i kontratave të lidhura për punë publike;
6. Aktiviteti i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit;
7. Ankesa e administruar në Klsh me nr. 798 prot. Datë 19.09.2023.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Fushë Arrëz (Kryetari i bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Përgjegjësi i Sektorit të Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, Drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Fushë Arrëz kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat

financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njesisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

II.6.Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Lloji i dokumentit: **Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore.**

Standardet e auditimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e
Audituesit të Pavarur, (IFAC);
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

Ligje: Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe
funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit
buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm
publik”;

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në
RSH”, i ndryshuar”

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave
Vendore”, i ndryshuar

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe
kontrollin”, i ndryshuar;

Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e
Territorit”, i ndryshuar;

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligji nr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i
ndryshuar;

Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

VKM: VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik”, i ndryshuar;

VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së
zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;

VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve
teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave
teknike të tyre”, i ndryshuar;

VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808,
datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave “Për dhënien e lejeve të
manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”;

Udhëzime:

VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar;

VKM nr.438, datë 8.6.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, i ndryshuar;

VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;

Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;

Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;

Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;

Udhëzimi i MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJVQ-ve”;

Udhëzimi i MFE nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj;

Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Rregullore:

Rregullore mbi organizimin e funksionimit të Bashkisë, etj.

II.7.Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 100, 200, 400, Manualit të Auditimit të Financiar dhe të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

II.8.Metodat e auditimit.

1. Kontrolli aritmetik.
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
4. Kontrolli i vlerësimeve.
5. Konfirmimi nga të tretët.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
7. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

II.9.Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve 8 gjithësej dhe akt-verifikimeve 1 gjithësej, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të

subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë edhe materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën në auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënime shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III.PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin në auditim:

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Fushë Arrëz”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara,

aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik.

Zona Gjeografike: Bashkia Fushë Arrëz i përket Qarkut Shkodër, kufizohet në veri me Bashkinë Tropojë, në perëndim me Bashkinë Vau i Dejës dhe jug-perëndim me Bashkitë Pukë dhe Mirditë. Në lindje kufizohet me Bashkinë Kukës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti Fushë-Arrëz. Përbëhet nga 5 Njësi Administrative si vijon: NJA Fushë Arrës; NJA Fierzë; NJA Blerim; NJA Qafë Mali dhe NJA Iballë.

Administrata e Bashkisë Fushë Arrëz dhe strukturat në varësi të saj, përbëhen nga:

-Këshilli Bashkiak (1 punonjës), Sekretari i Këshillit (1);
-Kryetari 1, Zv.Kryetari 2, Drejtori 2 (Drejtoria e Shërbimeve Publike (26), Drejtoria e Shërbimit pyjor (20), Sektorë 11 (Auditi i Brendshëm (3), Njësia për koordinimin e integritimit Evropian (1), Zyra One Stop Shop (1), Policia Bashkiake (3), Burimet Njerezore (2), Sektori Juridik (2), Financa (4), Çeshtjet Sociale (3), Planifikim Territori (3), Menaxhimi i mbetjeve (11), Shërbimet Publike (15), Taksat dhe Tarifat (2), Njësitë Administrative 4 (Njësia Administrative Qafë-Mali (7), Njësia Administrative Blerim (7), Njësia Administrative Fierze (9) Njësia Administrative Iballë (10), Zyra e Gjëndjes Civile (3).

Funksionet kryesore të Bashkisë Fushë Arrëz kryhen në fushën e:

Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Shërbimeve sociale.

Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.

Mbrojtjes së mjedisit.

Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.

Zhvillimit ekonomik vendor.

Sigurisë publike.

Financat.

Bashkia Fushë Arrëz ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a)krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b)vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c)harton, miraton dhe zbaton buxhetin e tyre;

ç)mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

-Për vitin 2022 nga Bashkia Fushë Arrëz janë shpenzuar gjithësej 270,352 mijë lekë, nga të cilat:

14,558 mijë lekë për investime;

134,123 mijë lekë për paga;

38,342 mijë lekë për mallra të ndryshëm;

108,187 mijë lekë për transferta në ndihmë ekonomike për familje në nevoj, invalidë etj.

-Për vitin 2022 Bashkia Fushë Arrëz nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithësej 15,035 mijë lekë.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditi i Brendshëm.

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetëtori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Fushë Arrëz, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Titulli i gjetjes: Mos funksionim i sistemit të Menxhimit dhe kontrollit

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, është pjesërisht efektiv, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë.
- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Nuk është miratuar Kodi i Etikës, por rregullat mbi etikën përshkruhen në rregulloren e brendshme, neni 13, Kreu III.

-Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Fushë Arrëz për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

“Menaxhimi i Riskut”

-Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Nuk është krijuar regjistri i riskut dhe nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut.

-Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.

-Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Fushë Arrëz.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

-Në Bashkinë Fushë Arrëz, mbajtja e kontabilitetit bëhet me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

-Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

“Informimi dhe komunikimi”

-Sipas komunikimit me personat përkatës në Bashkinë Fushë Arrëz dhe verifikimit të grupit të auditimit, faqja e bashkisë është jashtë funksionit, pra nuk sigurohet transparenca e institucionit dhe e drejta për informim.

-Për vitin 2022 nga Bashkia Fushë Arrëz (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin) nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

“Monitorimi”

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi F. T., Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, D. L., përgjegjësi i sektorit të financës, S. Gj., përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe L. N., përgjegjëse e sektorit juridik.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve,

me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit Juridik në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Fushë Arrëz.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.3455 prot., datë 14.11.2023, për sa më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

Citoj: Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2016 datë 15.10.2015, neni 10, nuk ka asnjë urdhër delegimi të kësaj kompetence tek Përgjegjësi i Financës. Pavarësisht sa cituar më sipër nga ana zyrës së Financës nëpërmjet tematikës së punës së miratuar ka caktuar të kryejë këtë proces Inspektori i Financës. Në këto kushte, pretendojmë që Akt Konstatimi nuk ka arsye të ketë emrin e Përgjegjësit të Financës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pasqyrimi pozicionit të Përgjegjësit të Sektorit të Financës, si person përgjegjës për disa nga mangësitë e evidentuara më sipër, është bërë bazuar në përcaktimet e bëra në Udhëzimin e MFE nr.16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, ku përcaktohen detyrat për çdo menaxher të njësisë publike (siç jeni dhe ju), përgjegjësitë për zyrën e financës (e cila drejtohet nga ju), në implementimin dhe zbatimin e sistemit të MFK, si dhe në Udhëzimin nr.21, datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve”, ku përcaktohen detyrat e NZ (siç jeni dhe ju) në implementimin dhe zbatimin e sistemit të MFK.

Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë.

III.2.1.1. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njesisë AB të Bashkisë Fushë Arrëz;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2022;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njesisë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm. Ky sektor përgjatë vitit 2022, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të VKB nr. 49, datë 23.12.2021 dhe Urdhrit nr.459, datë 13.12.2021, dhe ka pasur 3 punonjës përkatësisht, 2 specialiste dhe 1 përgjegjëse, e cila është ndryshuar tre herë gjatë vitit 2022.

Përgjatë vitit 2022, struktura i Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Fushë Arrëz, është;

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Larguar	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
Për vitin 2022									
1	P. P.	Përgjegjëse	Qershor 2021	Shkurt 2022	I lartë	18 vite	muaj	Jo	3 ditë
2	S. B. D.	Përgjegjëse	Maj 2022	Tetor 2022	I lartë	10 vite	3 muaj	Jo	0 ditë
3	A. Gj.	Përgjegjëse	Nëntor 2022	Prill 2023	I lartë	6 vite	6 muaj	Jo	0 ditë
4	L. Ç.	Specialiste	Maj 2019	-	I lartë	3 vite	6 muaj	Po	3 ditë
5	E. P.	Specialiste	Shkurt 2021	-	I lartë	12 vite	2 muaj	Po	3 ditë

Burimi: NJAB Fushë Arrëz, raportimi në MFE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së
Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2022.

Përgjatë vitit 2022, nga Sektori i Auditimit të Brendshëm, janë kryer gjithsej 3 auditime, ndarë si më poshtë vijon:

Viti 2022, plani vjetor i auditimeve i miratuar është përcjellë në MFE me shkresën nr. 2374 prot., datë 06.10.2021, sipas të cilit janë planifikuar për t'u kryer 6 auditime dhe janë realizuar 3 auditime të planifikuara për vitin 2022 dhe 1 auditim i mbetur pa u realizuar nga viti 2021, pasqyruar si më poshtë:

Nr	Planifikuar	Nr Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Sektori i Planifikimit të Territorit	1	Sektori i Rrugëve Rurale	1	1					1	
2	Sektori i Burimeve Njerëzore	1	Sektori i Planifikimit të Territorit	1	1					1	
3	Sektori i Çështjeve Sociale	1	Njësia Administrative Qafë-Mali	1	1					1	
4	Njësia Administrative Qafë-Mali	1	Njësia Administrative Iballe	1	1					1	
5	Njësia Administrative Iballe	1									
6	Drejtoria e Shërbimit Pyjor	1									
Totali		6	Totali	4	4	0	0	0	0	4	

Burimi: NJAB Fushë Arrëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2022 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 450 prot., datë 16.02.2023.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2022, rezulton se janë dhënë 20 rekomandime gjithsej, nga të cilat janë pranuar 20 prej tyre. Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi 10 prej tyre. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2022	20	0	10	10	10118	0	0	10118
TOTALI		20	0	10	10	10118	0	0	10118

Burimi: NJAB Fushë Arrëz, raportimi në MFE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Karta e Auditimit të Brendshëm është miratuar me urdhrin nr.23, datë 24.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz.

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm Publik në Bashkinë Fushë Arrëz, përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022.

Situata: Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk administrohet shkresa e ndryshimit të planit vjetor të auditimeve e miratuar nga titullari i institucionit dhe përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2022 të Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së

përcaktuar në shkronjën “ç” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu në raportin vjetor të aktivitetit, kreu IV.3 “Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre” nuk përmban plotësisht informacion sipas përcaktimit të bërë në formatin standard nr.5 “Struktura e raportit vjetor të njësisë të auditimit të brendshëm” në manualin e auditimit të brendshëm.

-Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit.

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

-Për vitin 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete me risk të lartë që kryen Bashkia Fushë Arrëz, si Sektori i Financës, Sektori Juridik, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, prokurimet e realizuara nga Bashkia Fushë Arrëz, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar, mbajnë përgjegjësi: Z. H. C., Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Znj. E. P., Specialist i Sektorit të NJAB.

Kriteri: Shkronja “ç” në nenin 6, shkronja “ç” pika 2 në nenin 11, nenin 12, nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

-Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

-Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lartë, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave

III.2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022.

Në zbatim të programit të auditimit, sa i takon buxhetit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni mbi fazat e përgatitjes dhe miratimit të PBA dhe buxhetit vjetor;

- Raportet e monitorimit;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Fushë Arrëz”;
- Vendime të tjera të Këshillit Bashkiak, në lidhje me ndryshimet buxhetore, etj

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes së PBA, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Me shkresë nr. 642/1, datë 16.03.2021, titullari i Bashkisë ka dërguar udhëzimin për përgatitjen e PBA, drejtuar Ekipeve të Menaxhimit të Programeve, shoqëruar me pasqyrat përkatëse.

Me VKB nr. 15, datë 26.03.2021 janë miratuar Tavanet Përgatitore të buxhetit afatmesëm 2022-2024, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Shkodër me shkresë nr. 3193, datë 27.04.2021 Me shkresën nr. 2157, datë 15.09.2021 është dërguar në MFE Dokumenti i PBA 2022-2024, për të cilin është marrë konfirmimi për vijim e fazës së dytë nga MFE. Miratimi përfundimtar i PBA 2022-2024 është bërë me VKB nr. 50, datë 23.12.2021, konfirmuar me shkresë nr. 35/1, datë 19.01.2022 të Prefekturës së Qarkut Shkodër.

Në tabelën në vijim paraqiten të dhënat mbi fazat e PBA 2022-2024 dhe Buxheti vjetor 2022.

Art.	Emertimi	PBA Faz I	PBA Faz II
600	Paga	122,474,000	134,258,000
601	Sigurime Shoqërore	20,213,000	22,071,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	36,892,000	43,346,000
604	Transferta Korente të Brendshme	7,517,000	9,091,000
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	99,687,000	99,687,000
230	Kapitale të Patrupëzuara		
231	Kapitale të Trupëzuara		5,520,000
	TOTAL	286,783,000	313,973,000

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor, si dhe çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Buxheti i vitit 2022 është miratuar me VKB nr. 50, datë 23.12.2021, konfirmuar me shkresë nr. 35/1, datë 19.01.2022 të Prefekturës së Qarkut Shkodër. Rezulton se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 207,945 mijë lekë. Transferta e pa kushtëzuar dhe të ardhurat e veta, janë burimi kryesor i buxhetit të Bashkisë. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Nga auditimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Fushë Arrëz, konstatohet se buxheti vjetor ka pësuar ndryshim gjatë vitit sipas nevojave të bashkisë. Me VKB nr. 27, datë 29.06.2022, “Për disa shtesa në VKB nr. 50, datë 23.12.2021, shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar të trashëguar, të ardhurave të trashëguara dhe transfertës specifike të trashëguar nga viti 2021, janë miratuar ndryshime në buxhet në vlerën totale 62,878 mijë lekë. Të dhënat e detajuara paraqiten si vijon:

Pasqyrë përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 sipas VKB përkatëse në mijë lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar VKB nr. 50 date 23.12.2021	Buxheti shtesë VKB nr. 27 date 29.06.2022	Vlera total	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë	Vlerat e total
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	28,555		28,555	Art. 600 Paga	132,433	15,485	147,918
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2021		15,691	15,691	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	21,766	2,897	24,663
Total të ardhurat e veta	28,555	15,691	44,246	Art.602 Shpenzime operative	43,346	13,867	57,213
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar				Art.604 Transferime korrente të brendshme	2,880	1,103	3,983
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike				Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë			
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022	81,069	29,164	110,233	Art. 230-231 Investime	5,520	29,526	35,046
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2022	98,321	18,023	116,344	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	2,000		2000
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	179,390	47,187	226,577				
TOTALI TE ARDHURAVE	207,945	62,878	270,823	TOTALI SHPENZIMEVE	207,945	62,878	270,823

Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Gjatë vitit 2022 janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Fushë Arrëz, për vitin 2022. Në lekë										
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi %	Burimi i financimit të shpenzimit					
					Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			
							Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet
1	Paga 600	138,187,600	114,948,707	83	283,393	0	51,243,395	61,908,680	1,513,239	
2	Sigurime shoqërore 601	24,114,000	19,174,372	80	1,304,634	7	6,337,025	11,290,933	241,780	

3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	56,082,000	38,342,035	68	9,139,844	24	14,495,898	14,706,293	
4	Subvencion Ujësjiellësi, etj. 603								
5	K. Q Emergj Civile 604	1,342,920	1,243,983	93	100,000	8	1,092		1,142,891
6	Nd/Ekonom invalid 606	109,404,400	108,187,004	99	540,000	0	1,969,000	2,307,400	103,370,604
7	Mjete ne ruajtje 466								
8	Investime 230-231	35,046,000	18,422,786	53	4,263,360	23	14,159,426		
Totali		364,176,920	300,318,887	82	15,631,231	5	88,205,836	90,213,306	106,268,514

Nga të dhënat e rakorduara me degën e Thesarit, rezulton se buxheti përfundimtar në vlerën 364,176,920 lekë është realizuar në vlerën 300,318,887 lekë ose në masën 82%. Nga auditimi konstatohet se në mos realizimin e plotë të buxhetit kanë ndikuar mos realizimi shpenzimeve operative të cilat rezultojnë në masën 68% dhe mos realizimi i investimeve të cilat janë realizuar në masën 53%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Fushë Arrëz në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Nga auditimi rezulton se rishikimi i buxhetit është bërë vetëm një herë gjatë vitit dhe nuk meren masa për përshtatjen e shpenzimeve sipas mundësive të Bashkisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Po kështu, konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari në vlerën 364,176 mijë lekë, nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit të miratuar që ka vlerën 375,351 mijë lekë, ose 11,175 mijë lekë më pak. Mos përputhja vjen pasi në buxheti përfundimtar sipas thesarit, nuk janë përfshirë të ardhurat e papërdorura në vlerën 15,846,000 lekë, si dhe është shtuar vlera e paparishikuar në PBA (shtesa gjatë vitit për shpërbllim dhe mbështetje financiare) tek ndihma ekonomike dhe PAK në vlerën 4,671,920 lekë.

Në vijim paraqitet lista e projekteve të investimeve të planifikuara për tu realizuar dhe ato të cilat nuk janë realizuar.

Në 000 lekë

Nr	Emërtimi i investimit	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar (me TVSh)
1	Rehabilitimi I plote I nyjes hidrosanitare te Godines se Bashkise	Te ardhurat e veta 05	300	288
2	Punime rehabilitimi ne rrugen e Gjinnazit dhe Rrugen Demokracia	Te ardhurat e veta 05	1600	1,512
3	Supervizim, Punime rehabilitimi ne rrugen e Gjinnazit dhe Rrugen Demokracia	Te ardhurat e veta 05	34	
4	Kolaudim, Punime rehabilitimi ne rrugen e Gjinnazit dhe Rrugen Demokracia	Te ardhurat e veta 05	4	
5	Sistemim asfaltim dhe ndriçim rruga urbane dytesore "Rinia"	Te ardhurat e veta 05	4,630	
6	Ndertim vepra arti (Ura) ne rruget autorurale, Lagje Arifaj dhe Lagje Likaj Njesia Qafe Mali	Te ardhurat e veta 05	2,560	2,463
7	Supervizim, Ndertim vepra arti (Ura) ne rruget autorurale, Lagje Arifaj dhe Lagje Likaj Njesia Qafe Mali	Te ardhurat e veta 05	61	
8	Kolaudim, Ndertim vepra arti (Ura) ne rruget autorurale, Lagje Arifaj dhe Lagje Likaj Njesia Qafe Mali	Te ardhurat e veta 05	7	
<i>Granti</i>				
1	Veshje dhe paisje per zjarrfikësit	Granti 01	1,520	1,403
2	Blerje autobot uji per sherbimin zjarrfikses	Granti 01	4,000	3,864
3	Ndertim i Godines se Njesise Administrative Blerim	Granti 01	5,650	5,629
4	Sherbim supervizioni: Godina e Njesise Administrative Blerim	Granti 01	80	
5	Sherbim kolaudimi:Godina e Njesise Administrative Blerim	Granti 01	10	
6	Rikonstruksion I shkolles Iballe	Granti 01	159	
7	Ndertim palestere dhe ambjente sportive	Granti 01	238	
8	Rikonstruksion I shkolles 70 vjetori I pavarisise	Granti 01	145	
9	Sistemim asfaltim dhe ndriçim rruga urbane dytesore "Rinia"	Granti 01	10,419	
10	Supervizim, Sistemim asfaltim dhe ndriçim rruga urbane dytesore "Rinia"	Granti 01	315	

11	Kolaudim, Sistemim asfaltim dhe ndriçim rruga urbane dytesore "Rinia"	Granti 01	33	
12	Vendosje te shresave te urave auto lagjia Koprati(Iballe)+fshati Micoj	Granti 01	1,000	984
13	Investim rrjeti i brendshem i Ujssjellesit qytet dhe depozitave ekzistuese.	Granti 01	2,281	2,281

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë

Konstatohet se për vitin 2022 janë parashikuar Fondi Rezervë në vlerën 1,000 mijë lekë dhe Fondi i Kontigjencës po në vlerën 1,000 mijë lekë dhe rezulton se asnjëri prej tyre nuk është përdorur. Ndërkohë Fondi i emergjencës është parashikuar në vlerën 1,142,920 lekë dhe është realizuar po në këtë vlerë, përdorur kryesisht për emergjenca nga fatkeqësitë natyrore.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Detyrimet e prapambetura viti 2022

Në 000 lekë

Emerimi i detyrimit te prapambetur	Deyrimi i prapambetur deri 31.12.2021	Detyrime krijuar gjate 2022	Pagesa gjatë vitit 2022	Detyrime të mbetura 31.12.2022
Detyrime vend.gjyqësore punonjës	5,922,207	1,630,601	2,744,347	4,808,461
D.P.per sherbime				
D.P.per mirembajtje				
D.P. vendime gjyqësore per investime	2,856,626		2,280,502	576,124
D.P.per investime nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)				
D.P per mallra				
D.P.te tjera				
Totali	8,778,833	1,630,601	5,024,849	5,384,585

Nga të dhënat rezulton se Bashkia Fushë Arrëz ka patur detyrime të prapambetura në fillim të vitit 2022 në vlerën 8,778,833 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime në vlerën 1,630,601 lekë dhe janë kryer pagesa në vlerën 5,024,849 lekë, duke mbartur një detyrim të prapambetur në fund të 2022 në vlerën 5,384,585 lekë. Nga auditimi rezulton se e gjithë vlera e detyrimeve të prapambetura përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore për largimet e pa drejta nga puna të punonjësve, si dhe nga vendimet gjyqësore mbi shkelje që lidhen me projektet e investimeve. Vetëm për vitin 2022 janë krijuar detyrime nga largimet e pa drejta nga puna në vlerën 1,630,601 lekë, të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë.

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022 jepen në tabelat në vijim:

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2022
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
4864100	Urdher pembarimi per A. p.	1,156,787	1,156,787	0		0

4864100	Urdher permbarimi per D. P.	729,200	729,200	0		0
4864100	Largim nga puna K. P.	304,202	60,000	244,202	10,000	254,202
4864100	Urdher permbarimi T. A. sha	222,658		222,658		222,658
4864100	Largim nga puna K. Ll.	1,396,320	60,000	1,336,320	121,600	1,457,920
4864100	Largim nga puna L. Gj.	641,552	90,000	551,552		551,552
4864100	Largim nga puna M.T.	933,128		933,128		933,128
4864100	Largim nga puna E.C.	342,360	342,360	0		0
4864100	Largim nga puna A.S.	196,000	196,000	0		0
4864100	Largim nga puna Z. Gj.		110,000	-110,000	756,765	646,765
4864100	Largim nga puna D. H.			0	742,236	742,236
4864400	Rikonstrukcionin I rrjetit te ujesjellesit dhe depove	2,280,502	2,280,502	0		0
4864400	Rikonstrukcion I Shkolles se bashkuar Iballe	194,055		194,055		194,055
4864400	Ndertim palestere dhe ambjente sportive	237,445		237,445		237,445
4864400	Rikonstrukcion I Shkolles se 70 vjetori I pavarsise Fushe Arrez	144,624		144,624		144,624
					1,630,601	5,384,585

Stoku i detyrimit të mbetur rakordooh me vleren e detyrimeve në sistemin e thesarit dhe atë raportuar në MFE si vijon:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0	270,823,000	
a	Hua sftatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	5,384,585		1,99%
a	Shpenzime korrente	0		
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	0		

b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	5,384,585		
c,1	Marrëdhënie pune	4,585,803		
c,2	Mallra dhe shërbime	222,658		
c,3	Investime	576,124		
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	5,384,585	270,823,000	1.99%

Në UMFE nr. 26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive. Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Fushë Arrëz, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta për vitin 2022 ka vlerën 270,823,000 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022, ka vlerën 5,384,585 lekë, raportuar edhe në MFE me shkresë nr. 415, datë 14.02.2023. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura meshpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 1.99%, shifër që e klasifikon Bashkinë Fushë Arrëz në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

Raportet e Monitorimit

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Bashkia Fushë Arrëz ka përgatitur dhe dërguar rregullisht në MFE raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit si vijon:

Me shkresë nr. 1358, datë 11.05.2022 është dërguar Raporti i monitorimit për 4 mujorin e parë. Me shkresë nr. 3629, datë 15.09.2022 është dërguar Raporti i monitorimit për 4 mujorin e dytë. Me shkresë nr.491, datë 22.02.2023 është dërguar Raporti i monitorimit vjetor për vitin 2022.

Observacionet e subjektit: Me shkresë nr. 871/9, datë 18.12..2023, janë dërguar komente mbi projekt raportin:

- Lidhur me afatet e përgatitjes së fazës së dytë të PBA, afate të cilat referuar neni 39 të ligjit 68/2017 janë respektuar;
- Mos realizimi i investimeve nuk ka ardhur si pasojë e mos realizimit të të ardhurave, pasi referuar rakordimeve me Thesarin, ka patur kesh limit gjendje.

Qendrimi i grupit të auditimit:

- Nga rishqyrtimi i konstatimit dhe bazës ligjore, komentet merren parasysh dhe pasqyrohen në projekt raport.
- Lidhur me sqarimin e gjendjes kesh për investimet, sqarojmë se pavarësisht motiveve, konstatimi mbetet dhe rezulton se buxheti paraqitet me mos realizim pikërisht në dy zërat, investime dhe mallra/shërbime.

Titulli i gjetjes 1: Mos realizimi i buxhetit

Situata: Nga të dhënat e rakorduara me degën e Thesarit, rezulton se buxheti përfundimtar në vlerën 364,176,920 lekë është realizuar në vlerën 300,318,887 lekë ose në masën 82%. Nga auditimi konstatohet se në mos realizimin e plotë të buxhetit kanë ndikuar mos realizimi shpenzimeve operative të cilat rezultojnë në masën 68% dhe mos realizimi i investimeve të

cilat janë realizuar në masën 53%. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masa për korrigjime gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara sipas treguesve realë. Nga auditimi rezulton se rishikimi i buxhetit është bërë vetëm një herë gjatë vitit.

Kriteri: Pika (a) e nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ndikimi: Mos përmbushja e nevojave për shpenzime të planifikuara.

Shkaku: mangësi në menaxhimin e investimeve të planifikuara.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 1.1: Sektori i Financës në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, si dhe të rishikuar përgjatë vitit , mbi bazë nevojash dhe mundësish realizimi si për investimet ashtu edhe për shpenzimet për mallra e shërbime.

Titulli i gjetjes 2: Krijimi i detyrimeve nga çështjet gjyqësore

Situata: Nga të dhënat rezulton se Bashkia Fushë Arrëz ka patur detyrime të prapambetura në fillim të vitit 2022 në vlerën 8,778,833 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime në vlerën 1,630,601 lekë dhe janë kryer pagesa në vlerën 5,024,849 lekë, duke mbartur një detyrim të prapambetur në fund të 2022 në vlerën 5,384,585 lekë. Nga auditimi rezulton se e gjithë vlera e detyrimeve të prapambetura përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore për largimet e pa drejta nga puna të punonjësve, si dhe nga vendimet gjyqësore mbi shkelje që lidhen me projektet e investimeve. Vetëm për vitin 2022 janë krijuar detyrime nga largimet e pa drejta nga puna në vlerën 1,630,601 lekë, të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

Ndikimi: Efekt financiar negativ për vitin 2022, në vlerën 1,630,601 lekë.

Shkaku: Largimet e padrejta nga puna të punonjësve

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 2.1: Titullari i Bashkisë në bashkëpunim me njësinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për vlerësime dhe vendimarrje korrekte në rastet e largimeve nga puna të punonjësve, duke argumentuar në çdo rast shkeljet e konstatuara, si dhe pas ndjekies me përpikmëri të çdo faze që parashikon kuadri ligjor përpara vendimarrjes finale për shkarkimin e punonjësit.

“Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor”.

Për sa më lart u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz për miratimin e paketës fiskale të vitit 2022;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifat vendore;
- Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2021;

- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Për vitin 2022 struktura e taksave dhe tarifave vendore ka në total 4 punonjës, nga të cilët 1 përgjegjës sektori, 1 specialist në Bashki, një specialist në NjA Iballë dhe 1 specialist në NjA Fierz dhe 3 specialistë, pasqyruar më poshtë:

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni	Lloji i shkollës	Urdhri i emërimit	Urdhri largimit	Pozicioni i punës
a	b	1	2	4	5	6
1	V.P.	Përgjegjës	Ekonomik	Nr.151 Dt:25.05.2021	-	Përgjegjës
2	M. C.	Specialiste	Mesme	Nr.34 Dt:10.01.2022	-	Specialiste NjA Qender
3	B. M.	Specialist	Mesme	Nr.71 Dt: 09.11.2015	Nr.407 Dt:02.10.2023	Specialist NjA Iballe
4	O. T.	Specialist	Mesme	Nr.261 Dt:09.08.2021	Nr.264 Dt:20.07.2023	Specialist NjA Fierz

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Për vitin 2022, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 48, datë 23.12.2021, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresë nr. 33/1, datë 19.01.2022. Në tabelën në vijim paraqiten të dhënat mbi planifikimin e të ardhurave të Bashkisë Fushë Arrëz dhe niveli i realizimit sipas zërave:

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
I	Të ardhura nga Tatimet			
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	-	109	-
II	Të ardhura nga Taksat			
2	Taksa trualli	412	1,768	429
3	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	6,813	2,656	38.9
4	Taksa mbi token Bujqësore	620	30	4.8
5	Taksa të tjera të ngjashme (Tarifë/Taksa)	-	398	-
6	Taksë mbi rregj. e Automjete	1,300	1,901	146.2
7	Taksa e ndikimit të nd. mbi infrastrukturën	600	95	15.8
8	Taksë Tabele, Ndriçimi	380	342	90
9	Taksë hoteli	21	-	-
10	Taksë Parkimi	206	9	4.3
11	Taksë për hapësira publike	210	144	68.5
12	Taksë nga renta minerare	3,273	-	-
III	Të ardhura nga Tarifat			
13	Tarifë Pastrimi	4,000	1,990	49.7
14	Tarifë leje karburanti	-	-	-
15	Tarifë leje transporti.	400	299	74.7
16	Tarifë për leje ndertimi	-	983	-
17	Të ardhura Jo Tatimore	620	580	93.5
IV	Të ardhura të tjera			

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
18	Qira Nga Toka Bujqesore	-	68	-
19	Qira kullote	6,500	5,636	86.7
20	Të ardhura nga shitja e druve te zjarrit	3,100	190	6.1
22	Të ardhura nga MNZH	-	711	-
23	Tatim mbi të ardhurat Personale 2%	-	2,300	-
24	Dhurata, sponsorizim & Garanci.	100	488	488
	GJITHSEJ (I+II+III+ IV)	28,555	20,697	72.4

Nga të dhënat rezultojnë se të ardhurat në Bashkinë Fushë Arrëz janë planifikuar në vlerën 28,555 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 20,697 mijë lekë ose në masën 72%, me një mos realizim në vlerën 7,858 mijë lekë. Mos realizimi i plotë i të ardhurave ka ardhur si pasojë e mos arkëtimit të taksave dhe tarifave kryesisht familjare, por edhe atyre të bizneseve dhe konkretisht zërat që paraqiten me nivel shumë të ulët realizimi janë taksa mbi tokën bujqësore realizuar vetëm 5%, taksa e ndikimit në infrastrukturë realizuar vetëm 16%, taksa e parkimit realizuar vetëm 4%, ndërkohë që nuk janë vjelur taksa e hotelit dhe e rentës minerare.

Krahas zërave me mos realizim, konstatohet se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka planifikuar të ardhura nga tatimi i thjeshtë mbi fitimin, tarifën për lejet e karburanteve, pavarësisht se në këtë Bashki operojnë të tilla, si dhe nga tatimi mbi të ardhurat personale 2%. Për sa më lart treguesi i realizimit të të ardhurave nuk është real.

Nga auditimi rezultojnë se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një databazë të saktë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Pjesa më e madhe e zërave të të ardhurave parashikohen mbi baza historike dhe jo mbi të dhëna të sakta të numrit të familjeve apo bizneseve. Duke mos patur një bazë të dhënash nuk janë kryer rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër (DRTB), Agjensinë Shtetërore të Kadastrës (ASHKK), Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTRR), etj. Po kështu edhe në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sipërfaqja e banimit që ka secila familje, sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, etj. Nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjellbërimit-ndriçimit.

Për detyrimet e familjarëve, konstatohet se nuk ka një marrëvshje me Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Fushë Arrëz Sh.A., në rolin e Agjentit Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit dhe rrjedhimisht nuk ka korrespondencë të dhënash mbi numrin e familjarëve dhe detyrimet përkatëse. Në tërësi rezultojnë se nuk mbahen regjistrat fizikë me të dhëna për bizneset dhe familjarët. Për këtë qëllim, Bashkia Fushë Arrëz operon me printimin rast pas rasti të formateve excel të të dhënave, të cilat nuk japin siguri për mbajtjen dhe administrimin e saktë dhe kronologjik të të dhënave.

➤ Taksa e tokës:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2022, u konstatua se Bashkia Fushë Arrëz nuk administron të dhëna të sakta mbi numrin e familjeve që zotërojnë toka bujqësore. Planifikimi i të ardhurave për këtë zë bëhet me përafërsi bazuar në të dhëna historike, kjo pasi Bashkia Fushë Arrëz nuk kryen rakordime apo kërkesë informacioni nga zyra përkatëse vendore e Kadastrës për marrjen e të dhënave mbi pasuritë e paluajtëshme të familjarëve. Bashkia Fushë Arrëz nuk disponon të dhëna analitike mbi

sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 7501 “Për tokën” çka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Nga njësia e tatim-taksave në Bashkinë Fushë Arrëz janë vënë në dispozicion të dhënat si vijon:

NJ.A.	Familje me tokë bujqësore	Sipërfaqe	Kategoria	Cmimi	Planifikimi	Likuidimi	Mosrealizim
Qender	370	150 ha	VII	700	105,000	4,500	100,500
Qafe-Mali	1315	455 ha	VII	500	227,500	12,500	215,000
Iballe	1309	652ha	VII	500	326,000	4,900	321,100
Blerim	889	521 ha	VII	500	260,500	3,500	257,000
Fierze	1261	544 ha	VII	500	272,000	2,500	269,500
Shuma		2322			1,190,500	27,900	1,163,100

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz dhe auditimet e më parshme të KLSH-së

Referuar sa më lart, rezulton se në tërësi për 2322 ha tokë bujqësore të disponuar nga familjet në të gjitha Njësitë, janë planifikuar të ardhura në vlerën 1,190,500 lekë dhe janë realizuar të ardhura në vlerën 27,900 lekë, ose në masën 2.4%. Nga taksa për tokën bujqësore paraqiten të ardhura të munguara në vlerën 1,163,100 lekë.

➤ **Regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave për detyrimet nga bizneset dhe ndërmarrjet shtetërore:**

Referuar të dhënave të marra nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Fushë Arrëz, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund
1	Biznesi Vogël				
		78	6	-	84
2	Biznesi Madh				
		31	1	-	32
(1+2)	Gjithsej				
		109	7	-	116

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022 kanë funksionuar 116 biznese dhe nuk ka patur mbyllje aktiviteteve. Në total rezulton se detyrimet për këto biznese janë për biznesin e vogël në vlerën 902,942 mijë dhe janë likuiduar në vlerën 651,768 lekë dhe për biznesin e madh detyrimet janë vlerën 4,371,399 lekë dhe janë likuiduar në vlerën 3,974,464 lekë. Për sa më lart, konstatohet se detyrimet nga bizneset në total mbeten në vlerën 648,108 lekë.

Detyrimet nga kontratat e qerave

Nga auditimi rezulton se për periudhën objekt auditimi, Bashkia Fushë Arrëz ka patur në fuqi 11 kontrata qeraje për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor kryesisht për ngritje antenash. Për vitin 2022 rezulton se detyrimi total i 11 subjekteve për kontratat e qerasë është 2,739,154 lekë, nga të cilat gjatë vitit 2022 kanë likuiduar detyrimet 6 subjekte në vlerën 977,906 lekë, ndërkohë që 5 subjekte rezultojnë debitorë në vlerën 1,761,248 lekë. Për subjektet “Lajthiza sh.a” dhe “Truen”, ka përfunduar afati i kontratës, ndërkohë që rezulton se subjekti “Lajthiza” ka shlyer në vitin 2022 detyrime që kanë qenë të hershme, ndërsa subjekti “Truen” ka ende detyrime të hershme, për të cilat Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masat e nevojshme shtrenguese për arkëtimin e detyrimit edhe pse kontrata ka përfunduar. Të dhënat për debitorët nga kontratat e qerave janë si vijon:

Nr	KONTRATA QERASE	E	DETYRIMI	KESTI 1	KESTI 2	KESTI 3	KESTI 4	LIKUJDUAR	DIFERENCA
1	A. sh.a F-A		314,000					314,000	-
2	A. sh.a Q-M		325,000					325,000	-
3	A. sh.a		150,000					-	150,000
4	L. SHA		31,501					31,501	-
5	A.P.		23,373					-	23,373
6	T.		212,250					-	212,250
7	W		917,875					-	917,875
8	O.		82,075					82,075	-
9	T.		315,500	78,875	78,875			157,750	157,750
10	V.A.		300,000					-	300,000
11	A. K.		67,580					67,580	-
	TOTALI		2,739,154					977,906	1,761,248

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Fushë Arrëz dhe Njësitë Administrative nuk kanë lëshuar autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit.

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	K. SHPK		-	-	1,000,000	-	1,000,000
2	L. SHPK		-	-	1,000,000	-	1,000,000
3	D.SHPK		-	-	1,000,000	-	1,000,000
4	V.T.SHPK		-	-	1,000,000	-	1,000,000
	SHUMA				4,000,000		4,000,000

Nga sa më lart konstatohet se të 4 subjektet që operojnë në fushën e tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre, nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017. Të gjithë subjektet më lartë rezultojnë debitorë në vlerën totale 4,000,000 lekë.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta**

Nga auditimi konstatohet se në rregulloren e brendshme të institucionit, nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me agjentët tatimorë si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët:

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblihet nga Agjenti Tatimorë “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DSHTRR)”, për llogari të Bashkisë Fushë Arrëz. Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësiteve përkatëse i kalojnë 25 për qind e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. Rakordimet me DRSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, nuk janë kryer.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mblihet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Shkodër”.

Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël” Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qëndrore, brënda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër për efekt të tatimit mbi fitimin e biznesit të vogël, nuk janë kryer rregullisht çdo muaj.

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblihet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP)”.

Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. Rakordimet me ZVRPP Shkodër, për taksën e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer.

4. Renta Minerare nga Agjentët Tatimorë “Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Shkodër”.

Në zbatim të të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, Neni 4 “Niveli i Taksave Kombëtare”, pika 4, e cila shprehet: “Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare....5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës....” të Udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008, dhe UMF Nr. 12, Dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, “...Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit...”. sipas shtojcës 2 të këtij ligji, niveli i Rentës Minerare varion nga 4 deri në 10%, sipas llojit të mineralit. Rakordimet me Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Shkodër, për Rentën Minerare, nuk janë kryer.

Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Bashkia Fushë Arrëz merr informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 117.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj... ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu VIII “Vlerësimi tatimor”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se bashkia Fushë Arrëz nuk ka të dhëna për numrin e familjeve debitore për periudhën objekt auditimi si dhe nuk ka dokumente analitike ku të jenë paraqitur zërat sipas taksave dhe tarifave dhe numrit të familjeve për taksat dhe tarifave familjare. Për këtë arsye, sa i takon përllogaritjes së borxhit tatimor bazohet vetëm në të dhënat e bizneseve, duke bërë që treguesit mbi situatën e borxhit të mos jenë realë. Situata e borxhit tatimor për vitin 2022 në Bashkinë Fushë Arrëz paraqitet në vijim:

Përshkrimi	Vlera e borxhit 31.12.2021	Borxhi i krijuar për 2022	Vlera e borxhit progresiv 31.12.2022
Debitorë familjarë	1,107,600	1,163,100	2,270,700
Debitorët biznes i vogël	218,635	251,173	469,808
Debitorët biznes i madh	306,100	396,935	703,035
Debitorët taksa e ndikimit në infrastrukturë	-	-	-
Debitorët qiratë	512,250	1,761,248	2,273,498
Total Borxhi	2,144,585	3,572,456	5,717,041

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Nga auditimi rezulton se **gjatë vitit 2022 është krijuar një borxh në vlerën 3,572,456 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për vitin 2022.** Në fund të vitit 2022, borxhi tatimor progresiv rezulton në vlerën 5,717,041 lekë.

Konstatohet se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë të gjitha masat e duhura shtrënguese për vjeljen e detyrimeve, pasi konstatohet se procedurat e ndjekura arrijnë deri në njoftim të subjekteve për shlyerje dhe nuk vijohet me bllokim të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë apo kallëzim penal, në kundërshtim me nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, dhe Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3.

Në tërësi, nga auditimi konstatohet se Bashkia Fushë Arrëz ka mangësi të theksuara në planifikimin kryesisht të të ardhurave nga taksat dhe tarifave familjare, kjo pasi nuk i ka të identifikuar dhe nuk ka asnjë bazë të dhënash për numrin e familjeve të ndarë sipas llojeve të taksave dhe detyrimeve që kanë ndaj Bashkisë. Bashkia Fushë Arrëz nuk kryen rakordime as me zyrën e Gjendjes Civile për identifikimin e tyre dhe as me Ndërmarrjen e Ujësjetës, apo zyrën Vendore të Kadastrës, në rolin e agjentit tatimor. Për sa më lart, sa i takon të ardhurave për abonentët familjar, nuk ka të dhëna të sakta, por përllogaritjet kryhen përgjithsisht në vlera të përafërta, apo duke përfshirë të dhëna historike ndër vite. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, ish Kryetari i Bashkisë z. F. T., përgjegjësi i Sektorit të Tatim-Taksave, z. V. P. dhe specialistët përkatës znj. M. C., z. B. M. dhe z. O. T., si dhe Këshilli Bashkiak, në cilësinë e miratuesit të Paketës Fiskale për vitin 2022.

Observacionet e subjektit: Me shkresë nr. 871/9, datë 18.12..2023, janë dërguar komente mbi projekt raportin si vijon:

- Vjelja e të ardhurave të familjarëve ka ardhur si pasojë e mos pasjes së të dhënave dhe adresave të familjeve si pasojë e emigrimit.
- Vjelja e të ardhurave nga bizneset ka ardhur pasi edhe pas njoftimeve të tyre për tu paraqitur, nuk janë shlyer detyrimet
- Duke qenë në periudhën e teknologjisë së informacionit, nuk e kemi parë të arsyeshme mbajtjen e regjistrave fizikë.
- Bashkia nuk ka të dhëna për familjet e pajisura me çertifikatë pronësie, pasi problemet me pronësinë janë të dukshme në gjithë Shqipërinë.
- Për subjektet debitore nga kontratat e qerave është bërë njoftimi për shlyerjen e tyre, por më tej duhet të veprojë zyra juridike.
- Për subjektet që tregëtojnë produkte në fushën e hidrokarbureve, pranë zyrës së taksave nuk është përcjellë asnjë autorizim nga zyra e shërbimeve publike, për këtë arsye nuk është marrë ndonjë masë për vjeljen e këtij lloji detyrimi.
- Lidhur me agjentët tatimor, zyra e taksave ka bërë periodikisht rakordime me Drejtorinë Rajonale Ttatiimore Shkodër si dhe DRSHTRR Shkodër sipas e-mail bashkëlidhur.

Qendrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i komenteve tuaja mbi mangësitë në realizimin e të ardhurave, sqarojmë se pavarësisht arsyeve që renditni, konstatimi mbetet dhe nuk është e justifikueshme që Bashkia nuk ka dijeni për subjektet apo abonentët familjarë në territorin e saj. Lidhur me mos mbajtjen e regjistrave fizikë, së pari ky fakt është në shkelje të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; neni 4. Së dyti, mbajtja e të dhënave vetëm në formatin Excel, nuk garanton siguri për mos fshirjen, mos modifikimin, apo edhe humbjen e të dhënave. Lidhur me subjektet tregtare të hidrokarbureve, pavarësisht se kjo është edhe përgjegjësi e zyrës së Shërbimeve Publike, vetë zyra e taksave ka detyrimin të rakordojë me zyrën e Shërbimeve Publike për sa kohë ka dijeni për ekzistencën e veprimtarisë së këtyre subjekteve. Së fundmi, lidhur me agjentët tatimor, për sa kohë shpreheni vetë se keni mangësi në të dhëna për pjesën më të madhe të debitorëve, procesi nuk mund të konsiderohet rakordim, por vetëm marrje informacioni mbi vlerat e arkëtuara dhe vetë zyra e taksave nuk mund të nxjerrë vlerën e pa arkëtuar.

Titulli i gjetjes 3: Mos realizimi i të ardhurave

Situata: Nga të dhënat rezulton se të ardhurat në Bashkinë Fushë Arrëz janë planifikuar në vlerën 28,555 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 20,697 mijë lekë ose në masën 72%, me një mos realizim në vlerën 7,858 mijë lekë. Mos realizimi i plotë i të ardhurave ka ardhur si pasojë e mos arkëtimit të taksave dhe tarifave kryesisht familjare, por edhe atyre të bizneseve dhe konkretisht zërat që paraqiten me nivel shumë të ulët realizimi janë taksa mbi tokën bujqësore realizuar vetëm 5%, taksa e ndikimit në infrastrukturë realizuar vetëm 16%, taksa e parkimit realizuar vetëm 4%, ndërkohë që nuk janë vjelur taksa e hotelit dhe e rentës minerare. Krahas zërave me mos realizim, konstatohet se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka planifikuar të ardhura nga tatimi i thjeshtë mbi fitimin, tarifën për lejet e karburanteve, pavarësisht se në këtë Bashki operojnë të tilla, si dhe nga tatimi mbi të ardhurat personale 2%. Për sa më lart treguesi i realizimit të të ardhurave nuk është real. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një databazë të saktë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Pjesa më e madhe e zërave të të ardhurave parashikohen mbi baza historike dhe jo mbi të dhëna të sakta të numrit të familjeve apo bizneseve. Nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Po kështu edhe për rastet e bizneseve, bashkia është mjaftuar me njoftimet shkresore për shlyerjen e detyrimeve dhe nuk është vijuar me masa të tjera. Si rezultat i të gjitha mangësive të mësipërme, për vitin 2022, në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz rezultojnë të ardhura të munguara në vlerën 3,572,456 lekë, për të cilat nuk është vijuar me marrjen e masave shtrënguese të arkëtimit.

Kriteri: Ligji nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

Pika (ç) e nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 29 pika 1, 88–104, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.

Ndikimi: Mos realizimi i të ardhurave.

Shkaku: Mos menaxhimi i kujdesshëm i hapave të nevojshëm në administrimin dhe mbledhjen e tarifave dhe taksave vendore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 3.1: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, të marrin masa për ngritjen e një grupi pune për fillimin e identifikimit të të gjithë abonentëve familjarë dhe bizneseve, në koordinim me zyrën e Gjendjes Civile dhe çdo agjent tjetër tatimor të cilët kanë të dhëna për këto subjekte, në mënyrë që planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga kjo Bashki të jetë sa më real. Për këtë, nëse do të jetë e nevojshme, të kërkohet edhe ndihma dhe bashkëpunimi i grupeve të punës të cilët kanë realizuar censusin në territorin e kësaj Bashkie. Të gjithë të dhënat të mbahen manualisht edhe në regjistrat fizikë, krahas atyre elektronikë.

Rekomandimi 3.2: Titullari i Bashkisë të marrë masa për caktimin e një personi përgjegjës pranë zyrës juridike, i cili në bashkëpunim dhe rakordim me zyrën e taksave dhe të ardhurave, do të iniciojë të gjitha procedurat e nevojshme shtrënguese, në rastet kur pas njoftimeve të debitorëve për shlyerjen e detyrimeve, nuk ka një reagim nga këta të fundit.

Rekomandimi 3.3: Zyra e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me zyrën Juridike, të marrin masa që për aq sa është e mundur të identifikohet, të fillojë procedura e marrjes së masave shtrënguese për vjeljen e të ardhurave të munguara, nëpërmjet bllokimit të llogarive, kallëzimeve penale apo mënyrave të tjera që parashikon legjislacioni në fuqi.

Titulli i gjetjes 4: Mangësi në operimin e subjekteve në fushën e hidrokarbureve.

Situata: Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Fushë Arrëz dhe Njësitë Administrative nuk janë lëshuar autorizimet përkatës për ushtrimin e aktivitetit. Si pasojë e mos rakordimit nga zyra e Shërbimeve Publike, të 4 subjektet që operojnë në fushën e tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre, nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar dhe rrjedhimisht të gjithë rezultojnë debitorë në vlerën totale 4,000,000 lekë.

Kriteri: VKM nr. 344, datë 19.04.2017“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Ndikimi: Mos ndjekja e procedurës për dhënien e autorizimit të tregtimit të karburanteve ka rezultuar në të ardhura të munguara në vlerën 4,000,000 lekë.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit me zyrën e Shërbimeve Publike.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 4.1: Zyra e Shërbimeve Publike të marrë masa për pajisjen me autorizimet përkatëse të të gjithë subjekteve që operojnë në fushën e tregëtimit të hidrokarbureve dhe pas plotësimit të dosjeve përkatëse me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të rakordojë me zyrën e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për përlllogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve nga pajisja me autorizime.

III.2.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregulator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2022, konkretisht:

Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2022 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
 - Pasqyrat financiare të vitit 2022;
 - Centralizatori;
 - Ditari i Bankës;
 - Ditari i Arkës;
 - Ditari i Magazinës;
 - Ditari i Pagesave;
 - Ditari i Veprimeve të ndryshme;
 - Aktrakordimet me Degën e Thesarit Pukë;
 - Inventarët etj.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2022 janë hartuar dhe depozituar më datën 28.03.2023 në Degën e Thesarit Pukë me shkresën nr. 858, Prot. Datë 28.03.2023.

Pasqyra përmbledhëse e bilancit për vitin 2022 me gjendjet e llogarive dhe ndryshimet e paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Qëllimi i auditimit: Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetëror do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Objektivat e auditimit: Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

- *Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullësia.*
- *Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.*
- *Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si: transaksionet, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.*

Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur në testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregulatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar: Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Bashkinë Fushë Arrëz, është realizuar në mbështetje të kërkesave të ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Pasqyrat financiare janë plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe formatet e miratuara nga Ministria e Financave.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.

▪ **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, ku janë është dhënë informacion mbi:
 - Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Fushë Arrëz;
 - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022;
 - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
 - Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 28.03.2023;
 - Përgatitur nga z.Dritan Lika;
 - Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Pukë me shkresën nr.858, datë 28.03.2023, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z. F. T.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Pukë të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Fushë Arrëz.

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve.

Gjendja e llogarive të Pasqyrave Financiare të Bashkia Fushë Arrëz paraqitet si më poshtë:

LLogaria	E M E R T I M I	Vlera vjetore
A	A K T I V E T	1,681,083,752
	I.Aktivet Afat shkurtra	393,868,118
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	81,576,243
520	Disponibilitete ne Thesar	81,576,243
	2.Gjendje Inventari qarkullues	10,297,442
32	Inventar I imet	9,992,584

35	Mallra	304,858
	3.Llogari te Arketushme	301,994,433
468	Debitore te ndryshem	284,293,539
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	17,700,894
	II.Aktivete Afat gjata	1,287,215,634
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	13,784,562
202	Studime dhe kerkime	13,784,562
21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,147,355,712
211	Pyje, Plantacione	5,088,456
212	Ndertesa e Konstruksione	460,490,157
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	647,682,716
214	Instalime teknike, makineri e paisje	6,606,157
215	Mjete Transporti	10,389,674
218	Inventar ekonomik	17,098,552
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	122,100,000
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	122,100,000
	4.Investime	3,975,360
231	Per Aktive Afatgjata materiale	3,975,360
B	PASIVET(DETYRIMET)	311,245,430
	I.Pasivet Afat shkurtra	311,245,430
	1. Llogari te Pagushme	26,951,891
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	1,108,590
42	Detyrime ndaj personelit	13,463,722
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	328,828
435	Sigurime Shoqerore	2,458,245
436	Sigurime Shendetsore	341,509
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	9,250,997
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	284,293,539
470	Llogari ne pritje - Te ardhura per tu marre	284,293,539
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,369,838,322
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,369,838,322
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,171,437,716
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	72,325,246
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	126,075,360
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1,681,083,752

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivete neto janë të barabarta me Aktivete-Pasivet = 311,245,430 lekë.

- Aktivete 1,681,083,752lekë
- Pasivet 311,245,430 lekë
- Aktivete neto 311,245,430 lekë

Aktivi i Bilancit

Aktivete afatshkurtra

Aktivete afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **393,868,118lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” në shumën 81,576,243lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 10,297,442lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 301,994,433lekë.

- Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 81,576,243 lekë, përbëhet nga: gjendja e fondeve në thesar me 31.12.2022 në shum 72,325,246 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në shumën 9,250,997 lekë.

- Mjetet në ruajtje përbëhen nga ndalesat e 5 % të garancisë së punimeve.

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në vlerën prej 81,576,243 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 73,799,693 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 73,799,693 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 81,576,243 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

Testimi i llogarisë nr.520

I.Të trashëguara nga viti 2021	
Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:	
Granti i trashëguar	47,187,000
Të ardhura të trashëguara	15,691,811
Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)	9,250,997
Totali	72,129,808
II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit 2022	
Granti i vitit	82,433,000
Të ardhurat e vitit	15,034,536
Të hyra nga mjetet në ruajtje	651,777
Granti specifik	79,171,000
buxheti	132,621,455
Totali	309,911,768
Totali i të ardhurave (I+II)	382,041,576
III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520 gjatë vitit 2022	
Paga sigurime (600+601)	134,123,079
Shpenzime operative (602)	38,342,035
Transferime korente të brendshme (604)	1,243,983
Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)	108,187,004
Investime (231)	14,558,840
Të dala nga mjetet në ruajtje (466)	2,342,983
Transferime korente të brendshme + transferita buxhetin e vet (418,470,743 +5,975,765)	1,667,409
Totali i shpenzimeve	300,465,333
(I+II) - (III)	81,576,243
Totali	81,576,243

-Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Fushë Arrëz në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 10,297,442 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 35 “Mallra” në vlerën 304,858 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 9,992,584 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -61,353 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” (pasqyra F2 – performanca financiare) në shumën 1,463,885 lekë.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Fushë Arrëz ka nxjerrë Urdhrin nr.424, datë 26.11.2022.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (debitor)” paraqitet me gjendje në shumën 11,451,697 lekë në fund të vitit 2021, ndërsa për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën 17,700,894 lekë. Vlerat e mëposhtme përfaqëojnë detyrimet e muajit dhjetor të cilat likujdohen kryesisht në muajin janar të vitit 2023.

421	431	435	436	401-408		Shuma
Paga Dhjetor 22	Tatime	Sig.shoq	Sig shend	Shpenzime operative	Investime	Viti 2022
8,877,919	328,828	2,458,245	341,509	238,958		
				64,800		
8,877,919	328,828	2,458,245	341,509	309,808	0	12,316,309

a. Tatim mbi pagë llogaria 6001 për vlerën 328,828 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2022.

b. Paga dhe shtesa mbi pagë llogaria 6001 për vlerën 8,877,919 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2022.

c. Sigurime Shoqërore llogaria 6010/6011 për vlerën 2,458,245 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2022.

d. Sigurime Shëndetësore llogaria 6010/6011 për vlerën 341,509 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2022.

e. Operative e mirëmbajtje dhe të përgjithshme për vlerën 309,808 lekë, konkretisht llogaria 6022. Tek kjo llogari është pasqyruar

Tek kjo llogari janë pasqyruar:

-Pagese per FSHU për muajin Dhjetor 2022 për vlerën 238,958 lekë.

-Pagesë për Ujësjellës Sha detyrim i muajit Dhjetor 2022 për vlerën 64,800 lekë sipas Fatures nr. 2, date 11.1.2023.

-Pagesë për shërbime postare për muajin dhjetor 2022 në shumën prej 6,050 lekë sipas faturës nr. 2250, date 6.1.2023.

Gjthashtu në këtë llogari janë të përfshira dhe detyrimet e prapambetura të cilat paraqitën në vlerën 5,384,585 lekë e cila paraqitet si mwposhtw:

Subjekti vendime gjykate	600-601	602-609	231	Vlera
T. A. sha		222,658		222,658
K. P.	254,202			254,202
K.LL.	1,457,920			1,457,920
L. Gj.	551,552			551,552
M. T.	933,128			933,128
Z. Gj.	646,765			646,765
D. H.	742,236			742,236
Shuma 1	4,585,503	222,658		4,808,461
Ivestime				
Objekti	600-601	602-609	231	
Rikonstruksion I Shkolles iballe			194055	194,055
Ndertim palestere dhe ambiente sportive			237445	237,445
Rikonstruksion I Shkolles se mesme Fushe Arrez			144624	144,624
Shuma 2	0	0	576,124	576,124
Totali				5,384,585

-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 është në vlerën 8,778,833 lekë. Lëvizjet kreditore dhe debitorë të kësaj llogarie pasqyrohen si më poshtë:

Llogaria 486	Viti 2021
Gjendja në fillim	8,778,833

Llogaria analitike nr.486

Objekti	Detyrimet në fund të vitit 2020	Shtuar	Pakësuar	Detyrimet në fund të vitit 2022
Vendim Gjykate për shërbime	1,156,787			1,156,787
Vendim Gjykate për shërbime	729,200			729,200
Vendim Gjykate për shërbime	222,658			222,658
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	2,433,423		2,433,423	-
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	374,202		70,000	304,202
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	1,496,320		100,000	1,396,320
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	671,552		30,000	641,552
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna	933,128			933,128

Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna		342,360		342,360
Vendim Gjykate për paga nga largimet nga puna		196,000		196,000
Investime në rikonstruksionin e ujesjellesit	2,280,502			2,280,502
Rikonstruksion i shkollës Iballë	194,055			194,055
Ndërtim palestere dhe ambiente sportive	237,445			237,445
Rikonstruksion i shkollës së mesme	144,624			144,624
TOTAL	10,873,896	538,360	2,633,423	8,778,833

-Gjendja e llogarisë 202 “Studime e projekte” në çelje të vitit 2022 gjendet në vlerën 23,960,531 lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 rezulton me këtë vlerë 19,692,232 lekë. Kjo shumë rakordon me inventarin sipas kartelave të personave që kanë në ngarkim.

Llogaria 202 “Studime e Projekte” ne pasqyrat e pozicionit financiar gjendet në vlerën 19,692,232 lekë vlerë e cila shpreh gjendjen e mbetur progresive ndër vite.

Ndryshime në këtë llogari paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Objekti	Shtesa	Pakesime
Projekti Godina e Njesise Blerim fature nr 90 date 15.11.2021. N. s. shpk ub 1550078		192,000
Projekt per rindertimin e mureve mbajtese te shesheve te pallateve ne qytetin Fushe Arrez		611,309
Projektim I objektit hapje rruge auto strame aprripe guri		75,692
Projekt "shtese pedonale+lulishite qytet fushe arrez"		200,892
Projket "Sistemim, asflatim, ndricim rruge auto lagje vjeter		104,424
Rikonstruksion I kanalit ujites fshati Iballë		2,542,826
Sistemim asfaltim rruga Lagje e re Fushe Arrez		541,156
Totali:		4,268,299

Pakësimet janë projekte të cilat janë realizuar punimet, janë marrë në dorëzim dhe i janë shtuar objekteve përkatëse në llogaritë nr.212 dhe 213.

-Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”, në çelje të vitit 2022 ka qenë në shumën 5,540,699 lekë, ndërsa në mbyllje të ushtrimit për vitin 2022 gjendet në vlerën 5,948,353 lekë, shtesa ka të bëjë me transferimin e këtij investimi nga llogari 231 “Investime në proces”.

Objekti	Shtesa
Pyllzime me drurë frutor Fierze	407,654
Totali:	407,654

Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” në çelje të vitit 2022 ka qenë në shumën 5,088,456 lekë. Për vitin 2022 kjo llogari gjendet në shumën 624,736,804 lekë, sic shihet gjatë vitit 2022 kjo llogari ka pësuar ndryshime dhe konkretisht ka këto shtesa në vlerën 148,633,839 lekë, të cilat janë transferime nga llogaria 231 “Investime në proces” nga vitet e kaluar si dhe sistemimi i investimeve të vitit të cilat janë marrë në dorëzim.

Këto shtesha janë paraqitur në mënyre tabelare si mëposhtë:

Objekti	Shtesa
Efienca e energjië në pallatin 5-katësh në bashkpronësi	5514070
Zgjerim dhe rrethim varreza Fashti Dardhe Sh. a shpk,UB 6177	3438274
Ndertim Shkolla Fierze V.ndertim is UB 6237	33166070
Ndertim palestere te shkolla mesme P. G.UB6267	47338356
Rikonstruksion i çatisë së godinës së Ish Drejtorisë pyjore, Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim.	749911
Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U. shpk UB 6403	14292923
Riparim I pjesshem I pallatit 79 A.shpk, kod projekti 1550087,fature 9 date 2.11.2021 .	827280
Riparim qsh arstmiliska A. shpk, kod projekti 1550082. fature 8 date 2.11.2021	398330
Rikonstruksione te pjesshme ne objekte sherbimi ne fshatra(mulli bloje) kod 1550088 A.	998912

Ndërtim i Godines se Njesise Administrative Blerim	5820804
Shtesë në pedonale dhe Lulishte në Qytetin Fushë Arrëz, + supervizim dhe kolaudim.P.G.	7174632
Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	28626277
Rikonstruksion I nyjes hidrosanitare godina e Bashkisë	288000
Totali:	148,633,839

Kjo shumë rakordon me inventarin e ndërtesave që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara për ndërtesat. Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 në fillim të vitit paraqitet me gjendje në vlerën 330,990,585 lekë duke pësuar ndryshime gjatë vitit konkretisht paksime për normat vjetore të amortizimit duke u pasqyruar në vlerën 460,490,157 lekë.

-Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në çelje të vitit 2022, ka qenë në shumën 741,055,152 lekë. Për vitin 2022 kjo llogari gjendet në shumën 809,244,327 lekë, sic shihet gjatë vitit 2022 kjo llogari ka pësuar një rritje prej 68,189,175 lekë, të cilat janë transferime nga llogaria 231 “Investime në proces” nga vitet e kaluar si dhe sistemimi i investimeve të vitit të cilat janë marrë në dorëzim, përkatësisht ato praqitën në tabelën e mëposhtme:

Objekti	Vlera
Ndërtim I rrjetit të brendshëm të ujësjellësit dhe depove ekzistuese UB 5811	2280502
Rikonstruksion rruga Mzi	3871437
Rikonstruksion Ujësjellsi Kash Berishë vogël	4548788
Rikonstruksion rruga Dardhe	3641241
Rikonstruksioni ndricimit qytet Sh.a. UB6235	997290
Rikonstruksion I kanalit Iballe P. gr., kod projekti 18AJ935, Ub 6271	32292499
Hapje rruge Strame Aprripe guri Sh.A., kod projekti 1550070, Ub 6447.fature 2200 date 11.8.2021	2530708
Sistemim asfaltim dhe ndriçim i rrugës auto lagjia e vjetër në Qytetin Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim P. G.	3849596
Hapje segmenti lidhes rruga auto Dardhe A. shpk, kod projekti 1550083.fature 10 date 2.11.2021	401304
“Sistemim Asfaltim Ndriçim i rrugës lidhëse pallati Demokracia” Keshilli I qarkut	628282
Riparim I pjesshem rruga auto Lumardh A.shpk, kod projekti 1550091.fature 6 date 19.10.2021	235872
Riparim I pjesshem Ura Shpoz A. shpk, kod projekti 1550090.fature 7 date 19.10.2021	178512
Riparim Ura pasarele Fshat Flet A.shpk, kod projekti 1550089.fature 14 date 9.11.2021	150000
Ndërtim I shpatullave te urave auto lagjia Koprati(Iballe)+fshati M. N.	12583144
Totali:	68,189,175

Kjo shumë rakordon me inventarin e rrugë, rrjete dhe vepra ujore që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2022 gjendet në vlerën 613,582,105 lekë ndërsa në fund të vitit ushtrimorë me gjendje prej 647,682,716 lekë.

Gjendja e llogarisë 214 “instalime teknike, paisje e vegla” në çelje të vitit 2022 ka qenë në shumën 3,160,400lekë, gjatë vitit 2022 ka patur ndryshime dhe në fund të periudhës paraqitet në vlerën neto prej 10,798,088 lekë me një shtesë prej 7,637,688 lekë të cilat janë transferime nga llogaria 231 “Investime në proces” nga vitet e kaluar, kalimi i dy makinerive, fadrome e rrugëve rurale dhe mjeti teknologjike e pastrimit (detyre e lënë gna Auditi i KLSH) si dhe sistemimi i investimeve të vitit të cilat janë marrë në dorëzim, përkatësisht ato praqitën në tabelën e mëposhtme:

Objekti	Vlera
Vendosje kamera sigurie në ambiente publike dhe Institucione në varësi të Bashkise Fushe Arrez R. shpk .UB 6180	2438688
Veshje dhe paisje per zjarrfikesit 14	1402800
Fadrome (rruge rurale)	1758000

Makine teknologjike	2038200
Totali:	7,637,688

Kjo shumë rakordon me inventarin e instalime paisje e vegla që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara. 214 “instalime teknike, paisje e vegla” në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2022 gjendet në vlerën 2,226,010 lekë ndërsa në fund të vitit ushtrimorë me gjendje prej 6,606,157 lekë.

-Gjendja e llogarisë 215, “Mjete transporti” në fund të vitit 2021 gjendet me shumën 16,195,475 lekë, gjatë vitit 2022 ka patur ndryshime dhe në fund të periudhës paraqitet në vlerën prej 19,250,835 lekë. Kjo llogari ka pa patur shtesa në vlerën 6,851,560 lekë dhe pakësime në vlerën 3,796,200 lekë, të cilat janë transferime nga llogaria 231 “Investime në proces” nga vitet e kaluar, pakësimi i dy makinerive, fadrome e rrugëve rurale dhe mjete teknologjike e pastrimit (detyre e lënë nga Auditi i KLSH) si dhe sistemimi i investimeve të vitit të cilat janë marrë në dorëzim, përkatësisht ato praqitën në tabelën e mëposhtme:

Objekti	Shtesa	Paksime
Blerje Kamioni	2988000	
Autobot uji per sherbimin zjarrfikses	3863560	
Fadrome (rruge rurale)		1758000
Makine teknologjike		2038200
Totali:	6,851,560	3,796,200

Kjo shumë rakordon me inventarin e mjete transporti që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara. Llogaria 215, “Mjete transporti” në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2022 gjendet në vlerën 7,055,463 lekë ndërsa në fund të vitit ushtrimorë me gjendje prej 10,389,674 lekë.

-Gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” ne celje të vitit 2022 është në shumën 27,899,253 lekë, sic shihet në mbyllje të vitit ushtrimor kjo llogari gjendet në vlerën 28,533,669 lekë, shtesat gjatë vitit 2022 në këtë llogari ka pësuar një rritje prej 634,416 lekë, përkatësisht këto janë shtesa pa pagesë gjatë vitit 2022 Paisje kompjuterike të cilat i janë dhuruar Bashkisë nga UNDP me dokument shoqërues nr. 1551 datë 26.5.2022.

E praqiture në mënyre tabelare si mëposhtë:

Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
Kompjuter Dell komplet + Printer Pyjore	set	1	172,800	172,800
Kompjuter Dell komplet + Printer Ceshkje sociale	set	1	153,872	153,872
Kompjuter Dell komplet + Printer Zyre Juridike	set	1	153,872	153,872
Kompjuter Dell komplet + Printer Inspektor pagash	set	1	153,872	153,872
Totali:				634,416

Kjo shumë rakordon me inventarin ekonomik që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara. Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2022 gjendet në vlerën 17,591,565 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022gjendet në vlerën 17,098,552 lekë, vlerë e cila shpreh gjendjen e mbetur pas amortizimit.

Gjendja llogaria 219 “Amortizimi” ne celje të vitit 2022 gjendet në shumën -293,827,414 lekë, pas llogaritjes së amortizimit për aktivet që disponon Bashkia Fushë Arrëz dhe shtesat/pakësimet gjatë vitit 2022 kjo llogari gjendet në vlerën 357,064,034 lekë.

Llogaria	Gjendja ne fillim	Shtesa	Gjendja ne fund
219.11	-859,897	0	-859,897
219.21	-145,112,380	19,134,267	-164,246,647
219.31	-127,473,047	34,088,564	-161,561,611

219.41	-934,390	3,257,541	-4,191,931
219.51	-9,140,012	2,597,419	-8,861,161
219.81	-10,307,688	1,127,429	-11,435,117

Gjendja llogaria 231 “Shpenzime per Rritjen e AQT në proces” në celje të vitit 2022 gjendet në vlerën 200,744,943 lekë, gjatë vitit 2022 ka pasur rritje dhe zbritje të kësaj llogarie dhe në total gjatë vitit 2022 kjo llogari kap vlerën 3,975,360 nga këto gjatë vitit 2022 janë marrë në dorëzim objekte dhe shtuar me shpenzime për objekte të reja të cilat kanë zvogëluar llogarinë 231 si dhe janë shtuar investime të kryera gjatë vitit, përkatësisht:

OBJEKTI	PAKESIM	
Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	2120103	28626277
Pyllzime me drurë frutor	2111300	407654
Rikonstruksion rruga Mzi	2133100	3871437
Rikonstruksion Ujësjellsi Kash Berishë vogël	2133100	4548788
Rikonstruksion rruga Dardhe	2133100	3641241
Efiçenca e energjië në pallatin 5-katësh në bashkëpronësi	2120102	5514070
Zgjerim dhe rrethim varreza Fashti Dardhe Sh. A.shpk,UB 6177	2120104	3438274
Vendosje kamera sigurie në ambiente publike dhe Institucione në varësi të Bashkise Fushe Arrez R. shpk .UB 6180	214.0290	2438688
Blerje Kamioni O.shpk , UB6180	2151140	2988000
Rikonstruksioni ndricimit qytet Sh.a. UB6235	2133100	997290
Sistemim asfaltim rruge lagje e vjeter P. G. UB6259	2133100	3692678
Ndërtim Shkolla Fierze V.n.UB 6237	2120103	29115000
Shtese pedonale P.G. UB6256	2133100	6911340
Ndërtim palestere te shkolla mesme P.G.UB6267	2120103	42149202
Rikonstruksion I kanalit Iballe P.g., kod projekti 18AJ935, Ub 6271	2133100	29749673
Rikonstruksion i çatisë së godinës së Ish Drejtorisë pyjore, Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim.	2120101	749911
Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U. shpk UB 6403	2120115	9235356
Rikonstruksion Shkolla Fierze V. n., U.shpk UB 6240	2120103	3226068
Supervizim + Kolaudim ne shkollat iballe,Fierze,Fushe Arrez	2120103	825002
Supervizim+kolaudim per objektin Ndertim I Palestres dhe ambienteve sportive Shkolla 70 vjetori I pavartesise	2120103	478693
Ndërtim palestere te shkolla mesme P. G. UB6268	2120103	4710461
Riparim I pjesshem I pallatit 79 A.shpk, kod projekti 1550087,fature 9 date 2.11.2021 .	2120102	827280
Riparim qsh arstmiliska A.shpk, kod projekti 1550082. fature 8 date 2.11.2021	2120105	398330
Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U. shpk Fat. 53 dt. 09.11.2021 UB 6403 kod 1550069	2120115	4220784
kolaudim Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez M. s.shpk Fat. 66 dt. 16.11.2021 kod 1550075	2133100	41474
Mbikqyrje Ndertim I mureve mbajtese te pallate 1550074	2133100	998912
Rikonstruksione te pjesshme ne objekte sherbimi ne fshatra(mulli bloje) kod 1550088 ADOAL	2133100	2399682
Hapje rruge Strame Aprripe guri Sh. A., kod projekti 1550070, Ub 6447.fature 2200 date 11.8.2021	2133100	5760
Kolaudim Hapje rruge re auto 1550073	2133100	49574
Supervizim Hapje rruge re auto	2133100	52494
Sistemim asfaltim dhe ndricim i rruges auto lagjia e vjetër në Qytetin Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim P. G.	2136100	401304
Hapje segmenti lidhes rruga auto Dardhe A.shpk, kod projekti 1550083.fature 10 date 2.11.2021	2133100	87126
Supërvizimin e objektit “Sistemim Asfaltim Ndricim i rruges lidhëse pallati Demokracia”	2136100	178512
Riparim I pjesshem Ura Shpoz A. shpk, kod projekti 1550090.fature 7 date 19.10.2021	2136100	235872
Riparim I pjesshem rruga auto Lumardh A. shpk, kod projekti 1550091.fature 6 date 19.10.2021	2133100	150000
Riparim Ura pasarele Fshat Flet A. shpk, kod projekti 1550089.fature 14 date 9.11.2021	2133100	3136336
Ndërtim I shtatullave te urave auto lagjia Koprati(Iballe)+fshati Micoj N.	2133100	26400
Totali:		200,744,943

Janë shtuar objekte në këtë llogari që i përkasin dy investimeve të mbetura në proces në fund të periudhës kontabël të cilat paraqiten përkatësisht sipas tabelës së mëposhtme:

<i>Objekti</i>	<i>Kod projekti</i>	<i>Vlera</i>
Ndertim ura lagje arifaj dhe likaj UB 7046, Kod projekti 1550095 D.shpk,fature 35 date 16.12.2022	1550095	2462892
Punime rehabilitimi rruga e gjimnazit dhe demokracia UB 7050, Kod projekti 1550098 D.shpk,fature 34 date 16.12.2022	1550098	1512468
Totali:		3,975,360

Kjo shumë rakordon me inventarin llogaria 231 “Shpenzime per Rritjen e AQT në proces” që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara.

-Gjendja llogaria 26 “Pjesmarrje ne kapitalin e vet” në celje të vitit 2022 gjendet në vlerën 0 lekë, gjatë vitit 2022 ka pasur rritje të kësaj llogarie në vlerën 122,100,000 e cila ka të bëjë me regjistrimin e aksioneve të ujësjellës kanalizime sipas rekomandimit 5/1 dërguar me shkresën nr. 885/11, datë 20/01/2023, të lënë nga Auditi i KLSH.

Pasivi i Bilancit

-Shuma e llogarisë sintetike të klasës 4 “Detyrimet afatshkurtra” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor) në aktivin e bilancit.

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në çelje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,431,343 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në shumën 1,108,590 lekë ndryshe nga viti i kaluar kjo llogari ka rënie pasi ka likuidime të detyrimeve të prapambetura. Kjo llogari ka detyrime ndaj të tretëve, detyrime VGJ, që pasqyron ne detaje në tablen më poshtë:

<i>Emertimi i detyrimit</i>	<i>Shpenzime operative viti</i>	<i>Investime detyrime</i>
Energji elektrike (OSHEE)	238,958	
Ujesjelles sha	64,800	
Poste	6,050	
U. Shpk		194,055
U.shpk		237,445
P. G.		144,624
Vendim gjykate per T. A.sha		222,658
Totali:	309,808	798,782

-Pagese per FSHU për muajin Dhjetor 2022 për vlerën 238,958 lekë.

-Pagesë për Ujësjetllës Sha detyrim i muajit Dhjetor 2022 për vlerën 64,800 lekë sipas Fatures nr. 2, date 11.1.2023.

-Pagesë për shërbime postare për muajin dhjetor 2022 në shumën prej 6,050 lekë sipas faturës nr. 2250, date 6.1.2023, Këto janë fatura të muajit Dhjetor 2022 të cilat janë likuiduar në vitin 2023.

-U. shpk, Rikonstruksion shkolla Iballe me kod projekti M112789 për shumën prej 194,055 lekë.

-Ndertim palestre dhe ambiente sportive P.g. për shumën 237,445 lekë.

-Rikonstruksion i Shkolles se mesme Fushe Arrez me subjekt U.shpk në vlerën 144,624 lekë.

-Vendim gjykate për T. a. në vlerën 222,658 lekë.

-Gjendjet e llogarive 421 “Personeli e llogari të lidhura me to”, në mbyllje të vitit 2022 është në shumën 8,877,919 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2022, ndërsa shuma prej 4,585,803 jane detyrime të prapambetura për paga për persona të larguar nga puna.

Objekti	Perfituesi	Vlera
Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	K.P.	254,202
Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	K.LI.	1,457,920
Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	L. Gj.	551,552
Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	M.T.	933,128
Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	Z.Gj.	646,765
Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	D.H.	742,236
Totali		4,585,803

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në mbyllje të vitit 2022 është në shumën 328,828 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2022.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” në mbyllje të vitit 2022 është në shumën 2,458,245 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2022.

-Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” në mbyllje të vitit 2022 është në shumën 341,509 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2022.

-Llogaria nr.466 “Kreditor për mjetet në ruajtje”, rakorduar me degën e thesarit, është analizuar analitikisht për çdo kreditor në lidhje me ngurtësimin e 5% të garancisë së punimeve të kryera për investime për vlerën 9,250,997 lekë.

-Llogaria nr.470 “Llogari në pritje - të ardhurra për tu marrë” paraqitet me gjendje 284,293,539lekë në fund të vitit 2022 që lidhet me llogarinë e debitorëve nr.468.

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën **1,369,838,322 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

Nr. Llogarie	Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,171,437,716	1,010,323,150
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	72,325,246	62,879,099
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		5,825,464
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	126,075,360	194,919,479
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	0
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
	Te Tjera	0	0

-Pasqyra e performancës financiare dhe rezultati i ushtrimit i pasqyruar në llogarinë nr.85 për vlerën 72,325,246 lekë është e rakorduar me akt-rakordimin e mbajtur në degën e thesarit Pukë. Lëvizja e kësaj llogarie pasqyrohet si më poshtë.

Nr.	Emërtimi i veprimeve	Shuma në lekë
1	Grante të trashëguara nga 2021 (Kapitull 1)	47,187,000
2	Të ardhura të trashëguara nga 2021 (Kapitull 5)	15,691,811
3	Grant i Akorduar për vitin 2022	81,069,000
3/1	Shtesë Granti për 2022	1,364,000
3/2	Investime që trashëgohen nga transferata specifike	2,046,217
4	Te ardhurat e vitit 2022	20,696,591
	Zbriten:	
-	Shpenzimet faktike Grante (Kapitull 1)	82,939,476
-	Shpenzimet faktike Të ardhura (Kapitull 5)	15,631,231
-	Shpenzimet faktike Transferata specifike	95,479,666
	Mbeten për përdorim në vitin 2022	72,325,246

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

Titulli i gjetjes: Devijime në kontabilizimin e llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Situata: Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2022 është në vlerën 283,626,978 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 284,293,539 lekë, pra me një rritje të vlerës së debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 999,561 lekë.

<i>Akt kontrolle</i>	<i>Kopeshte, Çerdhe</i>	<i>Ish-komunat</i>	<i>tatim taksa</i>	<i>Viti</i>
468	468	468	468	<i>Totali</i>
237,243,782	18,700	6,138,384	2,870,806	2022
	33,600		1,571,635	2021
			15,524,837	2020
			3,776,613	2019
			4,310,614	2018
			2,541,954	2017
			1,035,244	2016
			1,267,850	2015
			1,055,580	2014
			1,910,220	2013
			1,667,300	2012
			3,326,420	2011
237,243,782	52,300	6,138,384	40,859,073	284,293,539

Nga verifimi i listës analitike të debitorëve rakordimeve me drejtorinë e tatim taksave rezulton se kemi devijime në kontabilizimin e detyrimeve pasi për taksapaguesit familjarë detyrimet që rrjedhin nga taksa e pronës nuk janë të sakta, nuk ka një evidencë të saktë për numrin e familjeve, sipërfaqet e pronave që disponojnë si dhe detyrimin që i përlllogaritet si taksë mbi tokën bujqësore apo pronën private, në fund të vitit 2022, konstatohet se nuk është kontabilizuar detyrimi prej 3,572,456 që rrjedh nga detyrimet e familjarëve si dhe 99,859 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes dhe institucione, të cilët nuk kanë likuaduar detyrimet për taksat dhe tarifrat vendore sipas afatit të përcaktuar në paketën fiskale, pasqyruar si më poshtë vijon:

<i>Krijuar brenda vitit 2022</i>				
Biznesi i Madh	396,935	0.0006	150	35,724
Biznesi i Vogël	251,173	0.0006	150	22,605
Institucione	461,450	0.0006	150	41,530
Totali				99,859

Kriteri: Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12;

Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Fushë Arrëz në fund të vitit 2022.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

4. Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet me gjendje në shumën 11,451,697 lekë në fund të vitit 2021, ndërsa për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën 17,700,894 lekë.

Këto janë detyrimet e muajit dhjetor të vitit 2022, të cialt likuidohen në vitin 2023, gjendja paraqitet si më poshtë:

Të analizuara zë për zë detyrimet e muajit dhjetor 2022 paraiqten si më posht:

a.Tatim mbi pagë llogaria 6001 për vlerën 328,828 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2022.

b.Paga dhe shtesa mbi pagë llogaria 6001 për vlerën 8,877,919 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2022.

c.Sigurime Shoqërore llogaria 6010/6011 për vlerën 2,458,245 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2022.

d.Sigurime Shëndetësore llogaria 6010/6011 për vlerën 341,509 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2022.

e.Operative e mirëmbajtje dhe të përgjithshme për vlerën 309,808 lekë, konkretisht llogaria 6022. Tek kjo llogari është pasqyruar

Tek kjo llogari janë pasqyruar:

-Pagese per FSHU për muajin Dhjetor 2022 për vlerën 238,958 lekë.

-Pagesë për Ujësjellës Sha detyrim i muajit Dhjetor 2022 për vlerën 64,800 lekë sipas Fatures nr. 2, date 11.1.2023.

-Pagesë për shërbime postare për muajin dhjetor 2022 në shumën prej 6,050 lekë sipas faturës nr. 2250, date 6.1.2023.

Gjthashtu në këtë llogari janë të përfshira dhe detyrimet e prapambetura të cilat paraqitën në vlerën **5,384,585 lekë** e cila paraqitet si mëposhtë:

Llogaria per raportim Detyrime te prapambetura	Tipologjia e detyrimeve financiare	Operatori Ekonomik	Balanca
4013000	Vendime Gjykate per sherbime	T. A.sha	222,658
4213000	Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	K.P.	254,202
4213000	Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	K. Ll.	1,457,920
4213000	Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	L. Gj.	551,552
4213000	Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	M. T.	933,128
4213000	Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	Z. Gj.	646,765
4213000	Vendime Gjykate per paga nga largimet nga puna	D. H.	742,236
4043000	Rikonstruksion I Shkolles iballe	(V.n.) U.shpk	194,055
4043000	Ndertim palestere dhe ambjente sportive	P. G.	237,445
4043000	Rikonstruksion I Shkolles se mesme Fushe Arrez	(V.n.) U.shpk	144,624
Totali:			5,384,585

Në këtë llogari gjatë vitit 2022 Bashkia Fushë Arrëz ka bërë likudime dhe konkretisht është likuiduar detyrime per detyrime permbarimore ndaj A. në shumën prej 1,156,787 lekë gjithashtu janë bërë likudime për D. P. në shumën prej 729,200 lekë për detyrime për largime nga puna për K.P. në vlerën 60,000 lekë, K.Ll. në vlerën 60,000 lekë, L.Gj. në vlerën 90,000 lekë, E. C. në vlerën 342,360 lekë, për A. S. në vlerën 196,000 lekë, për Z.Gj. 110,000 lekë . Pas këtyre likuidimeve kjo llogari paraqitet sipas tabelës së mësipërme:

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 4342 “Të tjera Operacione me shtetin ””.

Situata: Llogaria nr. 4342 “Të tjera Operacione me shtetin ”, në fund të vitit 2022 paraqitet me një gjendje prej 5,384,585 lekë detyrime, të cilat rrjedhin si mos shlyerje e detyrimeve që rrjedhin nga procese gjyqësore dhe kontraktuale edhe pse për këtë vit ky detyrim është zvogluar me 2,744,347 lekë përsëri mbetet një problem i mbartur për Bashkinë Fushë Arrëz.

Në pasivin e bilancit:

B)

1. Shuma e llogarisë sintetike të klasës 4 “Detyrimet afatshkurtra” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor) në aktivin e bilancit.

2. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në çelje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,431,343 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në shumën 1,108,590 lekë ndryshe nga viti i kaluar kjo llogari ka rënie pasi ka likuidime të detyrimeve të prapambetura. Kjo llogari ka detyrime ndaj të tretëve, detyrime VGJ, etj.

2. Gjendjet e llogarive 421 “Personeli e llogari të lidhura me to”, në mbyllje të vitit 2022 është në shumën 8,877,919 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2022, ndërsa shuma prej 4,585,803 janë detyrime të prapambetura për paga për persona të larguar nga puna.

Objekti	Perfituesi	Vlera
Vendime Gjyqate per paga nga largimet nga puna	K.P.	254,202
Vendime Gjyqate per paga nga largimet nga puna	K. Ll.	1,457,920
Vendime Gjyqate per paga nga largimet nga puna	L. Gj.	551,552
Vendime Gjyqate per paga nga largimet nga puna	M. T.	933,128
Vendime Gjyqate per paga nga largimet nga puna	Z. Gj.	646,765
Vendime Gjyqate per paga nga largimet nga puna	D. H.	742,236
<i>Totali</i>		4,585,803

3. Llogaria 466 “Kreditor për mjetet në ruajtje”, rakorduar me degën e thesarit, është analizuar analitikisht për çdo kreditor në lidhje me ngurtësimin e 5% të garancisë së punimeve të kryera për investime e cila në fillim të periudhës ishte në vlerën 10,920,594 lekë, ndërsa në fund të periudhës paraqite në vlerën 9,250,997 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar.

Nr.	Objekti i investimit	Shuma Lekë	Kod.Projekti	Viti
	Ndërtim I rrjetit të ujësjellësit Krrab-Fushë Arrëz	293,122		2014
	Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	725,669	M112613	2015
	Rikonstruksion uëjsjellsi Buxhon	100	M063696	2015
	Pyllzime me drurë frutor	101,965	M260357	2015
	Rikonstruksion rruga Mzi	91,571	1550001	2015

Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	500,818	M112613	2015
Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	204,827	M112613	2015
Rikonstruksion Ujësjetisi Kash Berishë vogël	53,510	1550006	2015
Rikonstruksion Ujësjetisi Kash Berishë vogël	44,538	1550006	2015
Rikonstruksion Ujësjetisi Kash Berishë vogël	4,597	1550006	2015
Rikonstruksion Ujësjetisi Kash Berishë vogël	124,794	1550006	2015
Rikonstruksion godina e komunës Blerim	12,357	1550010	2015
Rikonstruksion rruga Dardhe	59,400	1550011	2015
Ndërtim ura tip beli Kryezi	240,000	M160907	2015
Efiçenca e energjië në pallatin 5-katësh në bashkpronësi	273,064	M940015	2016
Rikonstruksion sheshi dhe fasada pallatesh" UB 5810 +Supervizim+kolaudim	10,888	M991475	2017
Zgjerim dhe rrethim varreza Fashti Dardhe Sh. A. shpk,UB 6177	171,914	1550039	2018
Vendosje kamera sigurie në ambiente publike dhe Institucione në varësi të Bashkise Fushe Arrez R. shpk .UB 6180	121,934	1550043	2019
Blerje Kamioni O. shpk , UB6180	149,400	1550030	2019
Ndërtim I rrjetit të brendshëm të ujësjetisë dhe depove ekzistuese UB 5811	295,575	M063794	2019
Sistemim asfaltim rruge lagje Fushaxhi UB 5996	301,640	1550024	2019
Rikonstruksioni ndricimit qytet Sh. A. UB6235	49,865	1550042	2019
Sistemim asfaltim rruge lagje e vjeter P. G.UB6259	184,634	1550046	2019
Ndërtim Shkolla Fierze V.n.UB 6237	1,455,750	M112831	2019
Shtese pedonale P.G. UB6256	345,567	1550045	2020
Rikonstruksion I kanalit Iballe P.g., kod projekti 18AJ935, Ub 6271	1,447,768	18AJ935	2020
Rikonstruksion i çatisë së godinës së Ish Drejtorisë pyjore, Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim.	37,496	1550048	2020
Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U. shpk UB 6403	461,768	1550069	2020
Rikonstruksion Shkolla Fierze V. n., U. shpk UB 6240	161,303	1550053	2020
Riparim qsh arstmiliska A. shpk, kod projekti 1550082. fature 8 date 2.11.2021	19,917	1550082	2021
Rikonstruksion mure mbajtese Fushe Arrez U.shpk Fat. 53 dt. 09.11.2021 UB 6403 kod 1550069	211,039	1550069	2021
Rikonstruksione te pjesshme ne objekte sherbimi ne fshatra(mulli bloje) kod 1550088 A.	49,946	1550088	2021
Hapje rruge Strame A. g.Sh. Al, kod projekti 1550070, Ub 6447.fature 2200 date 11.8.2021	119,984	1550070	2021
Sistemim asfaltim dhe ndricim i rruges auto lagjia e vjetër në Qytetin Fushë Arrëz + supervizim dhe kolaudim P. G.	2,625	1550046	2021
Hapje segmenti lidhes rruga auto Dardhe A.shpk, kod projekti 1550083.fature 10 date 2.11.2021	20,065	1550083	2021
Riparim I pjesshem I pallatit 79 A. shpk, kod projekti 1550087,fature 9 date 2.11.2021 .	41,364	1550087	2021
Riparim I pjesshem Ura Shpoz A.shpk, kod projekti 1550090.fature 7 date 19.10.2021	8,926	1550090	2022
Riparim I pjesshem rruga auto Lumardh A.shpk, kod projekti 1550091.fature 6 date 19.10.2021	11,794	1550091	2022
Riparim Ura pasarele Fshat Flet A.shpk, kod projekti 1550089.fature 14 date 9.11.2021	7,500	1550089	2022
Ndërtim I shtatullave te urave auto lagjia Koprati(Iballe)+fshati Micoj Ndertuesi 2014	156,817	1550084	2022
Shtesë në pedonale dhe Lulishte në Qytetin Fushë Arrëz, + supervizim dhe kolaudim.Pepa Group	1,800	1550045	2022
Ndërtim godine Nj.administrative Blerim UB 6882, Kod projekti 1550079 N...shpk,fature 84 date 21.12.2022	281,440	1550079	2022
Ndërtim ura lagje arifaj dhe likaj UB 7046, Kod projekti 1550095 D.shpk,fature 35 date 16.12.2022	123,145	1550095	2022

Punime rehabilitimi rruga e gjimnazit dhe demokracia UB 7050, Kod projekti 1550098 D.shpk,fature 34 date 16.12.2022	75,623	1550098	2022
Blerje autobot uji per sherbimin zjarrfikses UB 6987, O.shpk fature 16 date 26.7.2022	193,178	1550093	2022
<u>Totali:</u>	9,250,997		

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 9,250,997 lekë për vitin 2021.

Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2023.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Llogaria e ngurtësimeve 5% në thesar të punimeve të ndërtimit që cilat nuk janë marrë në dorëzim ndër vite paraqitet si mëposhtë:

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi i Veprimeve</i>	<i>Shuma në lekë</i>
1	Garanci punimesh të vitit 2014	293,122
2	Garanci punimesh të vitit 2015	2,164,146
3	Garanci punimesh të vitit 2016	273,064
4	Garanci punimesh të vitit 2017	10,888
5	Garanci punimesh të vitit 2018	744,888
6	Garanci punimesh të vitit 2019	4,196,355
7	Garanci punimesh të vitit 2020	2,586,354
8	Garanci punimesh të vitit 2021	651,777
9	Garanci punimesh të vitit 2022	673,386
	Garanci të Përdorura gjatë periudhës korrente	2,342,983
<i>Mbetën për përdorim në vitet pasardhëse</i>		9,250,997

4. Rezultati i ushtrimit i pasqyruar në llogarinë 85 për vlerën 72,325,246 lekë është e kuadruar me akt-trashëgiminë e mbajtur në degën e thesarit në mbështetje të Ligjit Për Buxhetin e vitit 2022, ligjit Nr.139, Dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit të ministrit të Financave udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”. Gjatë vitit 2022 nga Bashkia Fushë Arrëz janë krijuar, përfutur dhe përdorur të ardhura/shpenzime gjithsej sipas tabelës së mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi i Veprimeve</i>	<i>Shuma në lekë</i>
1	Grante të trashëguara nga 2021 (Kapitull 1)	47,187,000
2	Të ardhura të trashëguara nga 2021 (Kapitull 5)	15,691,810.62
3	Grant i Akorduar për vitin 2022	81,069,000
3/1	Shtesë Granti për 2022	1,364,000
3/2	Investime që trashëgohen nga transfertat specifike	2,046,216.7

4	Te ardhurat e vitit 2022	20,696,591.4
5	Transferta specifike për vitin 2022	98,321,000
5/1	Shtesë Transferta specifike për vitin 2022	
	Zbriten:	
-	Shpenzimet faktike Grante (Kapitull 1)	82,939,476
-	Shpenzimet faktike Të ardhura (Kapitull 5)	15,631,231
-	Shpenzimet faktike Grant konkurues	
-	Shpenzimet faktike Transferta specifike	95,479,666
	Mbetën për përdorim në vitet pasardhëse	72,325,245.7

Pasqyrat financiare janë dorëzuar në Degën e Thesarit Pukë, me Nr. 858, datë 28.03.2023, në zbatim të udhëzimit Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, date 21.2.2022.

Gjithashtu këto pasqyra janë ngarkuar dhe në sistemin AFMIS sipas udhëzimit nr. 2, datë 19/01/2022 të MFE.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi Përgjegjësi i Sektorit të Financës z. D. L.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtarë të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 871/9, datë 18.12..2023, konkretisht nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës, dhe Kryetari i Bashkisë për sa më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

..Sa I përket llogarisë 468 ku thuhet se ka një rritje të kësaj llogarie, sqarojmë se zyra e financës ka kontabilizuar të gjithë debitorët të dërguar në mëshkresore nga zyra e tatim taksave (shkresa nr. 827, datë 23.03.2023) ... kjo shtesë ka të bëjë me taksa e tatime ndaj bashkisë Fushë Arrëz zyra e financës nuk ka vendimarrje apo përgjegjësi...

Llogaria 466 përbëhet nga garanci të punimeve në masën 5% dhe jo më tepër se kjo masë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

-Sa i përket observacionit për llogarinë nr.468, sqarojmë se nga verifikimi i listës analitike të debitorëve për vitin 2022, sqarojmë se nga ana jonë është identifikuar ky devijim nga bashkëpunimi midis audituesve ndërkohë që tek ju bashkëpunimi mes sektorëve mbase mungon, në çdo rast duhet një bashkëpunim mes sektorëve të Bashkisë për të harmonizuar zgjidhjen e problemeve dhe eliminimin e pasqaktësive, sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat.

-Sa i përket observacionit tuaj për llogarinë nr.466, sqarojmë se nuk kemi kuptuar mënyrën e të shprehurit, pra kur kemi thënë mbivlerësim, nuk konstatojmë se garancia e punimeve është mbajtur më tepër se 5%. Mbajtjen e garancisë në masën 5% e kemi pasqyruar edhe vetë përgjatë materialit, por mbivlerësimi ka të bëjë se për disa garanci punimesh është përmbushur afati dhe nuk duhet të jenë të kontabilizuara në llogarinë 466. Pra nuk jemi shprehur se masa e garancisë nuk është mbajtur në rregull, por që një pjesë e këtyre garancive duhet tu kthehet subjekteve përkatëse pasi ka kaluar afati I mbajtjes së garancive.

III.2.4. Mbi planifikimin dhe zbatimin procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për investime në punë publike.

4.1.Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrimit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

4.2.Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon*:

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, Bashkia Fushë Arrëz referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve ka kryer gjithsej **24** procedura prokurimi me vlerë kontrate **26,339,923.14** mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **818,437** mijë lekë ose 91%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ			
-Të hapura	1	12, 540, 545	11, 497, 684
- Kërkesë me propozim	0	0	0
- Shërbim konsulence	0	0	0
- Negocim pa shpallje	0	0	0
- E hapur e thjeshtuar	12	27, 158 ,360.14	26 ,339, 923.14
- Vlerë e vogël	10	3,587,215	3,206,482
Sipas objekteve			
-Objekte në fushën e punëve publike	4	17, 484, 997.14	16, 424, 079.14
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	9	22, 213, 908	21, 413 ,528

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **24** OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar **10** OE/BOE, dhe janë shpallurfitues **14** OE/BOE.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjodhi për auditim:

-7 procedura prokurimi për vitin 2022 me vlera kontrate **35,765,503** lekë, dhe vlerë e fndit limit **31,054,676** ose 78 % të fondit të kontratave të lidhura për vitin 2022;

1.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2022”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse (dru zjarri+pellet) për Bashkinë Fushë-Arrëz”,		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.438, datë 28.09.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.438, datë 28.09.2022 1. J. P. – Juriste 2. T. P. – Inxhinier 3. A.I. – Ekonomiste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.04, datë 14.10.2022 1. O.C. – Kryetar 2. A. D. – Anëtar 3. S. Ll. – Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar	6.Oferta fituese: OE “A” shpk” me ofertë 1,759,101 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 26.10.2022, me afat deri ne përfundim te sezonit te ngrohjes	7.Diferenca me fondin limit: 9, 201- lekë pa tvsh
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 1,768,302 - lekë pa tvsh	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit Buxheti i Bashkisë Fushë Arrëz	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 12.10.2022	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
11.Ankimime AK, Nuk ka		

b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4186, datë 26.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 2,110,921 lekë me tvsh.	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite 30 dite	19. Zgjatja e kontratës me - ditë

Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kërkesave për lëndë djegëse (dru zjarri dhe pelet).

-Burimi i financimit është nga buxheti i Bashkisë. Preventivi në vlerën 1,768,302 lekë pa TVSH është hartuar nga anëtari i NJP Inxhinier T. P. mbi bazën e kërkesave për sasi dru zjarri dhe pelet, nga 22 struktura (shkolla, kopshte, çerdhe, qendra kulturore), si dhe dokumentuar me tabelën e mëposhtme:

Nr	An	Emertimi I shkollave	Nr i sobave	Nr i kaldajave	Sasite qe kerkohen ne m3	Çmimet leke/m3	Vlera
1	Of	Shkolla 9-vjeçare F.-Arrez(dru)		2	50	4500	222,750
2	Of	Aneksi Micoj (dru)	1		2	4500	9.000
3	Of	Aneksi parashkollor F.-Arrez (dru)	1		2	4500	9,000
4	Of	Qkf Fushe-Arrez (dru)	5		15	4500	67,500
5	Of	Çerdhja Fushe-Arrez(dru)		1	33	4500	148,500
6	Of	Kopshti Fushe-Arrez (dru)	15		39	4500	175,500
7	Of	Gjimnazi -Fushe-Arrez (pelet)ne kg		1	5,240	70	366.800
8	Of	Shkolla 9-vjeçare Kryezi(dru)		1	26	4500	117,000
9	Of	Aneksi Orosh -Kryezi (dru)	2		4	4500	18.000
11	Of	Aneksi Lajthize -Kryezi (dru)	2		4	4500	18.000
12	Of	Aneksi Bardhet -Kryezi (dru)	2		4	4500	18.000
13	Of	Shkolla - Iballe (pelet) ne kg		1	1,650	70	115.500
14	Of	Aneksi Levozhe-Iballe (dru)	2		4	4500	18.000
15	Of	Aneksi Shopel-Iballe (dru)	1		2	4500	9.000
16	Of	Aneksi Berishe e Vogel-Iballe (dru)	2		4	4500	18.000
17	Of	Aneksi Berishe Vendi -Iballe (dru)	2		4	4500	18.000
18	Of	Aneksi Dushkaje -Iballe (dru)	2		4	4500	18.000
18	Of	Aneksi Bullica -Iballe (dru)	1		2	4500	9.000
18	Of	Aneksi Berishe e Eper -Iballe (dru)	1		2	4500	9.000
19	Of	Aneksi Mertur -Iballe (dru)	2		4	4500	18.000

20	Of	Shkollat e Nj. Adm. Blerim (dru)	13		34.0	4500	153.000
21	Of	Shkollat Fierze me (dru)	14		34	4500	153.000
22	Of	Shkolla Fierze (pelet) ne kg		1	856	70	59,920

Në preventiv është përcaktuar lloji i ngrohjes, me sobë ose kaldajë dhe produkti djegës, dru dhe pelet. Në procesverbalin për dokumentimin e përllogaritjes së fondit limit, NJP ka përcaktuar çmimin 4.500 lekë pa TVSH për drutë. Në përcaktimin e këtij çmimi, NJP shprehet se testoi tregun lokal dhe rajonal dhe studioi procedura të ngjashme të hartuara nga AK të ndryshme. **Referuar mbishkrimit në dosjen përkatëse nuk administrohet asnjë dokument bashkëlidhur (oferta të marra në treg nga subjekte të ndryshme, publikimit në INSTAT etj).**

-Pra arrihet në përfundimin se nga NJP nuk ka dokumentuar mënyra e përllogaritjes së vlerës së kontratës, në kundërshtim me pikat 1 dhe 4 të nenit 13 dhe pikën 2 të nenit 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Ndodhur në kushtet e mësipërme, ku nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së çmimit për dru zjarri dhe kosto e transportit për këtë lëndë punimi, me qëllim kryerjen e përllogaritjes, për të vlerësuar mundësinë e kursimit të fondeve, grupi i auditimit i’u referua çmimeve të përcaktuara në manualin e ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, konkretisht çmimet e materialeve të ndërtimit, tabela nr.2, rrjeshti 74, për lëndën djegëse (dru zjarri) me çmimin 2,500 lekë/m³ dhe çmimin mesatar 20.5 lekë/m³ të transportit (në manualin e çmimeve dhe të punimeve të ndërtimit me analizat përkatëse) të lëndës dru zjarri/m³, do të kishim 273 m³ dru zjarri të kërkuar gjithësej * 2520.5 lekë/m³ = 687,960 lekë pa TVSH gjithësej kosto për lëndën djegëse dhe transportin e saj, ndërkohë që sipas preventivit të mësipërm kosto e lëndës djegëse dru zjarri është 1,228,500 lekë, ose **540,540** lekë më tepër. *Pra sa më sipër arrihet në përfundimin se në prokurimin e lëndës djegëse dru zjarri, NJP mund të kursente fonde publike në vlerën **540,540** lekë, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit, si dhe mbështetur në analizën e mësipërme përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet⁶.*

Përsa më sipër, mban përgjegjësi hartuesi I fondit limit z.T. P.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në hartimin e fondit limit

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2022” me fond limit 1,768,302 - lekë pa tvsh u konstatua se nga NJP e përbër nga J. P., T. P. dhe A. I. në përllogaritjen e fondit limit nuk I janë nënshtruar asnjë nga format që parashikohet në legjislacion gjithashtu nuk kanë dokumentuar mënyrën e përllogaritjes së fondit limit në kundërshtim me parshikimet ligjore, duke sjellë një rritje të koston për dru zjarri me 540,540 lekë më tepër, vlerë e cila përbën efekt financiarë negativ.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pikat 1 dhe 4 të nenit 13 dhe pikën 2 të nenit 76. VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”

Ndikimi: Shpenzime pa efikasitet.

Shkaku: Mos argumentim dhe dokumentim I saktë I përllogaritjes së fondit limit

Rëndësia: E mesme

⁶ Pika 23 në nenin 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet: **“Përdorim me ekonomi”** është përdorimi i një sasive dhe cilësie të dhënë të inpueteve **(në këtë rast të fondeve të buxhetit të bashkisë)** në një kohë të dhënë dhe me koston më të ulët.

Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa që në çdo rast në përlllogaritje fondit limit ti nënshtrohen njëres nga mëqë parashikon ligji si dhe për çdo rast të marrin masat për dokumentimin e tij me qëllim menjanimin e problematikave të krijuara dhe menaxhimin e me efijencë të fondeve publike.

Hartimi i kriterëve nga NJP.

Në pikën 2.3.1 nga AK kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në masën jo më pak se 40% të vlerës së objektit që prokurohet të realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës – Ndërkohë sipas përcaktimit në shkronjën ”b” në pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vlera e furnizimeve të ngjashme duhet të kërkohet në masën jo më të madhe se 20%..

-Nuk është përcaktuar që OE shpallur fitues duhet të dorëzojë certifikatën për të vërtetuar origjinën e lëndës drusore⁷. –

-Gjithashtu, kërkesa e shtojces nr 5 pika 6 e DST, ndër të tjera kërkon nga OE fitues të sigurojnë ambiente për magazinimin e druve, pasi institucionet që do ti përdorin nuk kanë hapësira të tilla për mbajtjen e tyre për një kohë të gjatë. Kjo kërkesë, në kushtet e mungesës së magazinimit të lëndëve, është e pa plotë, pasi NJP nuk ka parashikuar vendndodhjen e magazinës ose distancën nga e cila do bëhet shpërndarja, çka potencialisht mund të përbëjë pengesë për shërbimin e shpërndarjes së lëndës djegëse, duke marrë parasysh dhe zonën malore dhe dimrin e ashpër-Transporti i druve dhe pelet deri në magazinën e Bashkisë duhet të bëhet nga subjekti fitues dhe dorëzimi i tyre duhet të bëhet në prani të komisionit të ngritur për këtë qëllim.

-Operatori fitues duhet të sigurojë ambiente për magazinimin e druve dhe pelet-it, deri në shpërndarjen për në destinacionin final, pasi Bashkia Fushë-Arrez, nuk ka hapësira të tilla për mbajtjen e tyre për një kohë të gjatë.

-Nuk është përcaktuar grafiku i lëvrimit të mallit, pra deri në datën kur do të përfundojë zbatimi i kontratës, vëndet ku do të dërgohet lënda djegëse.

Titulli i gjetjes: Parregullsi mbi procedurat e prokurimit public

Situata: Nga auditimi I procedurës së prokurimit me objekt “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2022” me fond limit 1,768,302 - lekë pa tvsh u konstatua se nga NJP e përbër nga J. P., T. P. dhe A. I.kriteret e vendosura për kualifikim nuk janë në harmoni me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe jo në përputhje me kuadrin ligjorë dhe rregullatorë në fuqi.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 55 pika 4 shkronjën ”b”.

Ndikimi: Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vlerësim i parregullt mbi llojin dhe sasinë e punës/shërbimit që kërkohet të prokurohet nga ana e njësisë së prokurimit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

-Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga, zj. J. P., z.T.P.dhe zj.A. I.

Vlerësimi i ofertave.

⁷ Shkronja “a” në pikën 8 në nenin 27 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”.

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	A. R.	1,759,101	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz me nr.04 prot, dt.14.10.2022 është ngritur KVO e cili përbëhet nga, z. O. Ç., Kryetar, z. A. D.dhe z. S. Ll., Anëtar.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A.R." ShPK me ofertë në vlerën 1,759,101 lekë pa TVSH me diferencë nga fondi limit në vlerën 9,201 lekë.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, rezulton se faturat tatimore dhe deklaratat e tatimit mbi vlerën e shtuar, pjesë e dokumentacionit për përmbushje të kriterit në pikën 2.3.1 "Kapaciteti teknik", janë fotokopje dhe jo të noterizuara.

-Sa më sipër, bazuar në përcaktimin e bërë në pikën 2 të nenit 82 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe përcaktimit të bërë në DST, që dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje e noterizuar e tyre KVO duhet të kërkonte anulimin e procedurës.

-Përsa më sipër, mban përgjegjësi KVO me përbërje, z. O. Ç., Kryetar, z. A. D. dhe z. S.Ll., Anëtar.

Të tjera çështje të krijuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit të lëndës djegëse dru zjarri.

Grupi i auditimit gjatë auditimit të procedurave të mësipërme, duke pasur në konsideratë burimet natyrore (florën) të disponueshme në teritorrin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe sipërfaqet pyjore dhe kullimore, të cilat me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive"⁸, të ndryshuar, vlerësoi nëse Bashkia Fushë Arrëz ka mundësinë (kuadri rregullator dhe kapacitetet), që lëndën djegëse dru zjarri ta siguroj nëpërmjet prerjeve në fondin e saj pyjor dhe jo ta blejë atë në subjekte private.

Sa më sipër, parashtrojmë si më poshtë vijon:

-Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator të fushës, pra të sektorit të pyjeve, rezulton se baza ligjore, konkretisht VKM nr.438, datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore", i ndryshuar, ka si objekt përcaktimin e procedurës, kriterëve dhe rregullave për shfrytëzimin e pyjeve për ngrohje të banorëve të Bashkisë.

-Për çdo vit nga struktura e pyjeve në këtë Bashki përcaktohet sasia e shfrytëzueshme e lëndës drusore për ngastrat/grup ngastrat, duke bërë miratimin projektit tekniko-ekonomik të trajtimit dhe shfrytëzimit të pyjeve.

-Bashkitë, brenda datës 30 prill të çdo viti, pasi vlerësojnë nevojat e komunitetit dhe enteve të tjera publike për dru zjarri, pa tejkualuar mundësinë e shfrytëzimit të pyjeve shtetërore dhe private, dërgojnë për miratim, në drejtorinë përkatëse, të Ministrisë së Mjedisit, kapacitetin dhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit.

-Ministria e Mjedisit, me urdhër të veçantë, miraton për çdo vit mundësinë vjetore të shfrytëzimit të pyjeve shtetërore dhe të pronarëve privatë për secilën bashki.

-Shfrytëzimi dhe trajtimi i pyjeve nga Bashkitë për sigurimin e nevojave për ngrohje, nxjerrja dhe magazinimi i tyre në sheshet e depozitimit, të përcaktuara paraprakisht, realizohet nga:

a) subjekte të licencuara, të kontraktuara nga Bashkia, në bazë të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, me objekt prerjen e materialit drusor në këmbë (të paprerë) dhe transportin e tyre;

⁸ 51. Sipërfaqet pyjore dhe kullimore, sipas listës së inventarit, dhe asete të tjera, që transferohen në pronësi të Bashkisë Fushë-Arës, janë sipas shtojcës 49, bashkëlidhur këtij vendimi. Shtojca përmban: a) listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 3 571 (tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një); b) godinën e DSHP.

b) ndërmarrjet e specializuara, të ngritura pranë Bashkisë.

Në Udhëzimin nr. 2, datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”, përcaktohet se:

-Nxjerrja e ngastrave për trajtimin e grumbujve pyjorë me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje do të bëhet me ekonomi pyjore. Vetëm në rastet e ndërhyrjeve kur nuk ka mundësi të krijohen grupngastra, do të bëhet me ngastër të veçantë.

-Trajtimi i pyjeve nga bashkitë për sigurimin e nevojave për ngrohje, nxjerrja dhe depozitimi i tyre në sheshet e përcaktuara paraprakisht do të realizohet nga **subjektet me licencë të kontraktuara nga Bashkia** për prerjen e lëndës drusore në këmbë dhe transportin e materialit drusor deri në sheshin e depozitimit të Bashkisë ose nga ndërmarrjet e specializuara të ngritura në bashki.

-Me kompaninë që shpallet fituese nga tenderimi për trajtimin e fondit pyjor, me qëllim vjeljen e druve të zjarrit për ngrohje dhe vjeljen e prodhimeve drusore e jodrusore, lidhet kontrata. Në kontratë pasqyrohen vëllimet e lëndës drusore në këmbë sipas llojeve dhe asortimenteve që do të prodhohen për çdo ngastër pyjore, datat e fillimit e përfundimit të prerjes, nxjerrjes e stivimit së materialit drusor në anë të rrugës dhe të kolaudimit të ngastrave dhe nënngastrave.

-Në vijim të sa më sipër për periudhën 2021-2022, me qëllim kryerjen e prerjeve rigjeneruese të fondit pyjor, si dhe sigurimin edhe të lëndës djegëse për ngrohje, **nga DSHP Bashkia Fushë Arrëz, janë hartuar dhe miratuar projektet e shfrytëzimit**, të cilat i janë përcjellë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, konkretisht:

-Me shkresën nr.1788 prot., datë 30.07.2021 Bashkia Fushë Arrëz i është drejtuar MTM, e cila me urdhrin nr.8550/2 datë 09.12.2021 ka miratuar shfrytëzimin e pyjeve për periudhën 2021-2022;

Gjithashtu në projektet e mësipërme janë miratuar edhe sheshet e depozitimit të druve të zjarrit.

-Gjithashtu u verifikuan regjistrat e realizimit, si dhe procedurat e shpallura në sistemin elektronik të prokurimeve për periudhën e mësipërme, me qëllim vlerësimin nëse nga Bashkia Fushë Arrëz përgjatë kësaj periudhe është realizuar apo testuar tregu për kontraktimin e shërbimit të prerjes së druve. **Nga ky verifikim rezultoi se në asnjë rast nuk është kryer një veprim i tillë, pra të jenë ftuar subjekte të cilat ushtrojnë aktivitet në shfrytëzimin e fondit pyjor, për të ofruar shërbimin e prerjes së druve, apo të jetë parashikuar në regjistrin e procedurave të prokurimit, të jetë shpallur si procedurë në sistemin elektronik dhe mos të ketë pasur asnjë subjekt të interesuar për të ofruar këtë shërbim.**

- U verifikua edhe regjistri i taksave dhe tarifave vendore, ku rezultoi se në teritorrin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz, ushtrojnë aktivitet disa subjekte, që kanë objekt aktiviteti “shfrytëzim i fondit pyjor”, të cilat mund të ofrojnë shërbimin e prerjes së druve.

-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se nga Bashkia Fushë Arrëz përgjatë periudhës 2022, nuk janë marrë masa për të vlerësuar mundësinë e kontraktimit të shërbimit të prerjes së druve pyjor, pasi edhe transportin e lëndës djegëse dru zjarri, e cila e ka mundësinë ta sigurojë vetë, pa pasur nevojën e kontraktimit të tij.

-Në kushtet e mësipërme, duke marrë në konsideratë kuadrin rregullator, burimet natyrore, kapacitetet e nevojshme, praninë e subjekteve me aktivitet të tillë, arrihet në konkluzionin se burimet (financiare, njerëzore, natyrore dhe kuadri rregullator) nuk janë përdorur në përputhje me parimet e eficiencës dhe ekonomicitetit, ***për rrjedhojë fondet e përdorura për blerjen e lëndës djegëse dru zjarri, në vlerën 540,540 lekë gjithësej, përbëjnë shpenzime pa eficiencë dhe ekonomicitet***

-Mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar në kundërshtim me Udhëzimin me nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik 35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta

originale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen pika b. Dokumenta vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arketimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

Për sa më sipër, mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 1 të nenit 8 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, mbanë përgjegjësi ish titullari i Bashkisë Fushë Arrëz, z. F. T.

2.Tenderi me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për mjetet për vitin 2022”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për mjetet motorrike të Bashkisë Fushë-Arrëz”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.468, datë 13.10.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.468, datë 13.10.2022 1. J. P. – Juriste 2. T. P. – Inxhinier 3. A. I. – Ekonomiste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.04 datë 28.10.2022 1. O. C. – Kryetar 2. A. D. – Anëtar 3. S.LI. – Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 2 119 166- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE- “L. T.” shpk me ofertë 2,050,000 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 07.11.2022, me afat 20 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 69,166- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27.10.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4335, datë 07.11.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 2,460,000 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 20 ditë,	19. Zgjatja e kontratës me - ditë S’ka

Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kritereve.

Burimi i financimit është nga buxheti i Bashkisë Fushë Arrëz.

Nga auditimi i kësaj procedure është konstatuar se: Nga NJP, fondi limit është bazuar në kërkesat për nevoja nga drejtuesit e automjeteve dhe dokumentuar me një procesverbal formal me nr. prot, 4000, i datës 13,10,2022 nga NJP.

- Pra arrihet në përfundimin se nga NJP nuk është dokumentuar mënyra e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, në kundërshtim me pikat 1 dhe 4 të nenit 13 dhe pikën 2 të nenit 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Ndodhur në kushtet e mësipërme, ku nuk dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së çmimit dhe vecanërisht përcaktimi i kritereve të vecanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike nuk janë dokumentuar në një procesverbal në të cilin duhej të analizohej dhe argumentohej teknikisht dhe ligjërisht sipas kërkesave të nenit 76 pika 2 dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për rregullat e prokurimit publik“, i ndryshuar ku citohet se: *Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon.* Kërkesat duhet të ishin të argumentuara nga **inxhinier mekanik ose mekanik të**

licencuar apo dhe servis automjetesh për t'i dhënë forcë ligjore të dokumentuar saktë kësaj procedure.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në hartimin e fondit limit

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje pjesë këmbimi për mjetet motorrike të Bashkisë Fushë-Arrëz” me fond limit) 2,119,166 lekë pa tvsh u konstatua se nga NJP e përbër nga J.P., T. P.dhe A. I. në përlllogaritjen e fondit limit nuk i janë nënshtruar asnjë nga format që parashikohet në legjislacion gjithashtu nuk kanë dokumentuar mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit në kundërshtim me parshikimet ligjore.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pikat 1 dhe 4 të nenit 13 dhe pikën 2 të nenit 76.

Ndikimi: Mungesë transparence në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Mos argumentim dhe dokumentim i saktë I përlllogaritjes së fondit limit

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa që në çdo rast në përlllogaritje fondit limit ti nënshtrohen njëres nga mëqë parashikon ligji si dhe për çdo rast të marrin masat për dokumentimin e tij me qëllim menjanimin e problematikave të krijuara dhe menaxhimin e me efijencë të fondeve publike.

Vlerësimi i ofertave.

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	L.T.	2,050,000	<i>Kualifikuar dhe shpallur fitues</i>

Nga auditimi rezulton se në garë ka marrë pjesë vetëm 1 OE:

L. T. me ofertën në shumën 2,050,000 lekë pa TVSH me një diferencë nga fondi limit 69, 166 lekë pa tvsh.

-KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “L. T.“, i cili sipas KVO i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST.

Lidhur kontrata me nr .4335 date 07,11.2022 midis Bashkisë së Fushë Arrëzit dhe OE fitues.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij operatori, rezulton se ky operator ekonomik i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe për këtë arsye KVO e ka shpallur fitues në përputhje me kërkesat dhe kriteret e hartuara nga NJP në DST.

-Mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar në kundërshtim me Udhëzimin me Nr. 30, Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen **pika b**. Dokumenta vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arketimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

3-Tenderi me objekt: “Shërbim dhe mirëmbajtje në pyje Bashkia Fushë-Arrëz” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim dhe mirembajtje në pyje, Bashkia Fushë-Arrëz”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.466, datë 12.10.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.466, datë 12.10.2022 1. J. P. – Juriste 2. T.P. – Inxhinier 3. A.I. – Ekonomiste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.3 datë 26.10.2022 1. O. C. – Kryetar 2. A.D. – Anëtar 3. S. Ll. – Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar		

5.Fondi Limit (pa Tvsh) 2, 966 664- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE- "4..." shpk me ofertë 2,889,409 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 07.11.2022, me afat 45 dite	7.Diferenca me fondin limit: 77, 255- lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 26.10.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë/ Shtetit Buxheti i Bashkise	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4337, datë 07.11.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 3,467,291 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 45 ditë,	19. Zgjatja e kontratës me - ditë S'ka

Qëllimi i kësaj procedure prokurimi është përmirësimi dhe ulja e dendësisë së drurëve në parcela nëpërmjet largimit të drurëve të bungës me zhvillim jo të mirë dhe që kanë të meta si, kërcëj të shtrembër, me shumë nyje e degëzime me kurorë të zhvilluar jo uniformisht ose ata që kanë mbetur mbrapa në rritje.Parcelat janë në zonat e Arifaj, Përroi i Qafë Benës, Kryezi, Prroni i Madh dhe Shpati Arifaj.

Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kriterëve.

Burimi i financimit është nga buxheti i Bashkisë së Fushë Arrëzit.

Nga auditimi i kësaj procedure është konstatuar se: Nga NJP është hartuar procesverbali i fondit limit me nr.3970 i datës 12.10.2022, ku është bazuar në projekt- preventivin për përmirësimin e pyjeve hartuar nga inxh pyjor D. Ll., preventiv ky i argumentuar pa Nr, dhe pa datë,

Për përmirësim të pyjeve në zonat e Arifaj, Përroi i Qafë Benës, Kryezi, Prroni i Madh dhe Shpati Arifaj me pozicionet e objektit nënparclat 81C, 86b në EK Pyjore Kryezi Bicaj“ dhe 59a, 112/b, 114/c EK Pyjore Kryezi ndodhet ne; **81/c**(V-Parcela 114/v, J-Parcela 81/b, L-Parcela 82/b/a, P- Parcela 115/b,) **86/b** (v-parcela 86/a, J-Parcela 103/a, L-Parcela 104/a P-Parcela 87/c) **59/a**(V-Parcela 60a, J-parcela 59/b, L-parcela 61 ,P-parcela 58/b), **112/b** (V-pacela 66, J-parcela 114/c, L-parcela 112a, P-parcela 62/b), **114/c** (V-parcela 113/b, J-parcela 115/b, L-parcela 113/a, P-parcela 114/a)

-Nga auditimi i hartimit të vendosjes së kriterëve dhe specifikimeve teknike u konstatua se këto kriterë nuk janë në harmoni me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet për arsye se:

Në hartimin e preventivit të punimeve nga NJP, është përllogaritur një sasi prej 1,236 ditë pune me një normë ditore prej 500m² /punëtor në ditë, për një sipërfaqe prej 618,055 m² pyll e nevojshme për pastrim me afat kontrate 45 ditë.

Nga përpjestimi i ditëve sipas preventivit (1236 / 45 = 27 punonjës) me afate kohore të kontratës rezulton se duhen 27 punonjës për kryerjen e kësaj pune ndërkohë nga NJP në kriteret e vecanta për kualifikim pika 2.3 kapaciteti teknik, nën/pika 2.3.4 kërkohet që OE duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 15 punonjës, një numer ky shumë i ulët për realizimin e punës për 45 ditë.

Gjithashtu për këtë kriter NJP, nuk ka kërkuar as listëpagesat për të vërtetuar disponibilitetin e punonjësve sipas kodeve të profesioneve bazuar në VKM me nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombetare të profesioneve (LKP)“ të rishikuar, për të vërtetuar dhe dëshmuar disponimin e punonjësve sipas natyrës së kontratës.

Titulli i gjetjes: *Parregullsi mbi procedurat e prokurimit publik*

Situata: Nga auditimi I procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim dhe mirëmbajtje në pyje Bashkia Fushë-Arrëz” me fond limit 2,966,664 lekë pa tvsh u konstatua se nga NJP e përbër nga J.P., T. P. dhe A. I. kriteret e vendosura për kualifikim nuk janë në harmoni me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe jo në përputhje me kuadrin ligjorë dhe rregullatorë në fuqi.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 55 pika 4 shkronjën ”b”.

Ndikimi: Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vlerësim i parregullt mbi llojin dhe sasinë e punës/shërbimit që kërkohet të prokurohet nga ana e njësisë së prokurimit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

-Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga, zj. J. P., z.T.P. dhe zj.A. I.

Vlerësimi i ofertave.

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	4... shpk	2,889,409 lekë	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Nga auditimi rezulton se në garë ka marrë pjesë vetëm 1 OE:

Te kjo procedurë ka marrë pjesë vetëm 1 OE “4...” Sh.P.K me ofertën në shumën 2,889,409 lekë pa TVSH me një diferencë nga fondi limit 77, 255 lekë pa tvsh.

-KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE-në “4...” , i cili sipas KVO i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST por në argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim në kriteret e vecanta të kualifikimit të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë sqarohet:

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licensë me Kodin III.7.A, me nënkategori-Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota, licensë kjo që nuk është ngarkuar në sistemin elektronik SPE si dhe nuk disponohet ne dosje por nga ana jonë është verifikuar se kjo licensë e OE “ 4...” SH.P.K ekziston në sistemin elektronik në QKB.

Bashkia Fushë Arrëz me OE ka lidhur kontratën me nr. 4337 datë 07,11.2022.

-Me shkresën me nr .542 datë 08.11.2022 ka dalë urdhëri për monitorimin e kontratës me objekt shërbime e mirëmbajtje në pyje Bashkia Fushë Arrëz me komisionin e përberë nga punonjësit, J. M.,A. D. dhe D. Ll.

Plani i zbatimit të kontratës me nr .4408 prot, datë 09.11.2022. Bashkia Fushë Arrez, me nr. 4863 prot,datë 20.12.2022, ka hartuar urdhërin e grupit të punës për marjen në dorëzim të punimeve me komision Kryetar D. Ll. dhe anëtarë M.M. e M.Ll., bashkëlidhur procesverbalet e dorëzimit të ngastrave pyjore, relacionet e marrjes në dorëzim të punimeve për përmirësim pyjesh bashkëlidhur fotot përkatëse.

4.Tenderi me objekt:“Blerje karburanti Diesel për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2022”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti Diesel për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2022".		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 57, Datë 17/02/2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 57 dt. 17.02.2022 1. J.P. 2.T. P. 3.A.I.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 42 dt. 10.02.2022 -O. Ç. , Kryetar, -S.LI., Anëtar. -A. D., Anëtar,
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur e thjeshtuar		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,720,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "D...", sh.p.k, me marzh fitimi 23lek/liter.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 lekë.
8. Data e hapjes së tenderit 03/03/2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 899, datë 30.03.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 8,064,000 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 12 muaj, Zbatuar 12 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë S'ka

Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kërkesave për karburant.

-Fondi limit është përlllogaritur në vlerën 6,720,000 lekë pa TVSH, si dhe miratuar me procesverbalin datë 15.02.2022. Në procesverbalin e mësipërm nuk pasqyrohet përlllogaritja e fondit limit, konkretisht pasqyrohet informacioni se NJP iu referua çmimeve të publikuara në buletinin e APP nr.19 datë 14.02.2022, testimi të tregut lokal dhe rajonal por në asnjë rast nuk pasqyrohet testimi, (çmimi në bursë për ton, shtesat për ton, aplikimin e taksave kombëtare, si dhe më e rëndësishmja përcaktimi i marzhit të fitimit). Veç sa më sipër, nuk dokumentohet se kujt subjekteve që tregëtojnë karburant i është drejtuar NJP me qëllim marrjen e ofertave prej tyre për të testuar tregun.

-Sasia totale e nevojshme për konsum për vitin 2022 është bërë sipas kërkesave nga 10 sektorë, përkatësisht: Policia Bashkiake; Drejtoria e Shërbimit Pyjor; Sektori i Shërbimeve Publike; Sektori i Rrugëve Rurale pa sasi; Administrata; Njësia Administrative Iballë, njësia administrative Fierzë dhe Sektori i Zjarrëfikses, Njësia Administrative Blerim, Njësia Administrative Qaf Mali si dhe një kërkes për shtes fondit prej 504,000 lek për transportin e urës së lëvizhme të ofruar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (që mesatarisht i korrespondon 2500litra sipas çmimit të përlllogaritur nga NJP)

-Nga auditimi i kërkesave të bëra për sasinë e nevojshme të karburantit, konstatohet se përjashtuar Policinë Bashkiake, në asnjë rast nuk pasqyrohet targa e automjetit, për të përlligjur nevojën për karburant të sektorit përkatës, gjithashtu në kërkesën e datës 19.01.2022 të sektorit të rrugëve rurale nuk kemi të përcaktuar sasinë e nevojshme duke e lënë tejte e evazive këtë proces, ky sektor ka në administrim Kamionin dhe fadromën për pastrimet lirimet e rrugëve rurale.

-Gjithashtu, asnjë prej kërkesave të mësipërme nuk dokumentohet me program pune vjetor, ku përcaktohen punët që do të kryhen nga secili sektor, për të arritur në vlerësimin e sasisë së nevojshme për karburant.

Nga auditimi i kërkesave rezultoi se sasia e kërkuar është 28,340 litra si dhe sektori i rrugëve rurale me sasi të pa përcaktuar.

Nga auditimi i çmimit dhe sasive të përlllogaritura nga NJP kemi pasaktësi -Në përfundim është caktuar 194.6 lekë/litër dhe sasia 41,440 litra, pra vlera totale 8,064,000 lekë me TVSH.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, J.P., T. P. dhe A. I., të cilët veç përllogaritjes së fondit limit, duhet të kishin arsyetuar edhe kërkesën për sasinë e karburantit, ose në rast të kundërt nuk duhet të kishin pranuar kërkesat e bëra nga sektorët e mësipërm, me qëllim kthimin dhe plotësimin e tyre.

Hartimi i kritereve dokumentuar me procesverbalin datë 15.02.2022 nga NJP.

Pika 2.2.1 - Vertetim ku të deklarohet se ka realizuar xhiro mesatare vjetore për një vit deri në 40% të fondit limit që prokurohet, kjo e realizuar për tre vitet e fundi. Ndërkohë në nenin 55 pika 4 e VKM 285 DATë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shprehet se: Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave. Pra Ak nuk mund të kërkoj xhiro më të madhe se 40% e vlerës së fondit në kriteret e DST por kjo sdo të thotë që nëse OE sjell një xhiro më të madhe se kërkesa e vendosur dhe AK ta skualifikoj siç mund të interpretohet kriteri i vendosur nga NJP Vertetim ku të deklarohet se ka realizuar xhiro mesatare vjetore për një vit deri në 40% të fondit limit.

Sic vihet re NJP ka kërkuar xhiro mesatare për një vit deri në 40%, në interpretim të përcaktimeve ligjore shprehet qartë se :Ak nuk mund të kërkojë në DST vertetim ku të deklarohet se ka realizuar xhiro mesatare vjetore për **një vit deri në 40%** të fondit limit që prokurohet, pasi në asnjë rast nuk shprehet se nëse OE paraqet vërtetim xhiro me vlerë më të madhe se 40% çfar ndodh; NJP duhet të shprehet qartë në hartimin e DST që ato të jenë të kuptueshëm dhe të interpretohen drejt.

Pika 2.2.2. Kopje të bilancit kontabel të konfirmuara nga tatimet për vitin 2021.

Ndërkohë në nenin 55 pika 4 e VKM 285 DATë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shprehet se: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Pika 2.3.3 - Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

EN- ISO 9001:2015 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të cilësisë;

EN- ISO 14001:2015 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të mjedisit;

Nuk argumentohet vendosja e certifikatave të mësipërme dhe rolin që kanë ato në vërtetimin e cilësisë së mallit që prokurohet. Për certifikatën OHSAS 18001:2007 nuk është vendosur edhe mundësia e dorëzimit të certifikatës ekuivalente të saj ISO 45001:2018, e njohur nga standardet shqiptare.

-Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur distanca maksimale e pikës së furnizimit me karburant në raport me Bashkinë Fushë Arrëz, duke bërë edhe një analizë kosto oportune të distancës që duhet, për arsye se ky kriter mbron interesat e institucionit, pasi mospërcaktimi i këtij kriteri sjell që në këtë procedurë të marrin pjesë edhe subjekte të cilat kanë stacione furnizimi në qytete të tjera dhe në këto kushte nuk është praktike që mjetet e Bashkisë Fushë Arrëz të shkojnë në një qytet tjetër për tu furnizuar me karburant dhe më pas të kthehen në qytetin Fushë Arrëz për të kryer punën/aktivitetin për të cilin është autorizuar të kryejë.

Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” është kërkuar që furnizimi i mjeteve të realizohet nëpërmjet tollonave, ndërkohë që sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të VKM nr.561, datë 29.7.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, duhet që njësitë e qeverisjes së përgjithshme ku përfshihet dhe Bashkia Fushë Arrëz të sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

Titulli i gjetjes: *Parregullsi në hartimin e kriterëve*

Situata: Nga auditimi I procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburanti Diesel për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2022”, me fond limit 6,720,000 lekë pa tvsh u konstatua se nga NJP e përbër nga J.P., T. P. dhe A. I. kriteret e vendosura për kualifikim nuk janë në harmoni me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe jo në përputhje me kuadrin ligjorë dhe rregullatorë në fuqi.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenet 41 dhe 55 pika.

Ndikimi: Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vlerësim i parregullt mbi llojin dhe sasinë e punës/shërbimit që kërkohet të prokurohet nga ana e njësisë së prokurimit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 49 dhe 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 41 dhe 55 -Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, J. P., T. P. dhe A. I..

Vlerësimi i ofertave

-KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me Urdhër Nr. dt. 10.02.2022 dhe përbëhet nga O. C., Kryetar, S.Ll. dhe A. D., Anëtar.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, dhe është dhe shpallur fituese OE “D...” ShPK me marzh fitimi 23lek /litër.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenet 90, 94 dhe 99 VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të maturuara për energjinë elektrike të maturuara për muajin janar 2022, duke qënë se data e fundit dorëzimit të ofertave është 03.03.2022.

-Nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar licenca për tregëtimin e karburanteve për stacionin e furnizimit në Bashkinë Fushë Arrëz dhe Bashkinë Tiranë, ndërkohë që nga Bashkia Fushë Arrëz, është lëshuar vërtetimi se subjekti nuk ka detyrime për taksa dhe tarifa vendore. Në vijim të këtij vërtetimi të lëshuar ndaj OE shpallur fitues dhe bazuar në përcaktimin e bërë në nenin 4, nenin 15, nenin 17, nenin 19, nenin 20 dhe nenin 21, si dhe Kreun II në VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar, duhet që subjekti të pajisej me licencën për tregëtimin e karburantit për stacionin e furnizimit në Bashkinë Fushë Arrëz, duke u bërë automatikisht subjekti i tarifës vendore në vlerën 1,000,000 lekë që paguhet për llogari të Bashkisë Fushë Arrëz. Pra subjekti ka ushtruar aktivitet pa licencë në teritorrin administrativ të Bashkisë Fushë Arrëz dhe për rrjedhojë ka detyrimin për tu pajisur dhe likujduar tarifën përkatëse. Në këto kushte subjekti është shpallur fitues në kushtet e mungesës së licencës së mësipërme.

-Certifikata laboratorike e lëshuar nga ISHTI për cilësinë e naftës, i përket vetëm mostrës së marrë në pikën e furnizimit “A.P.” me adresë Rruga Ali Demi, pra jo edhe në pikat e tjera të furnizimit, me të cilat subjekti ka marrë pjesë në procedurën e tenderit, ndërkohë që në DST është përcaktuar shprehimisht: “OE duhet të paraqesë fletë-analizë të lëshuar nga ISHTI për produktin për cilësinë, sigurinë në tregim dhe garancinë e pikave të shitjes” gjithashtu ky raport analizash mban datën 19.02.2021 nëse OE ofron këtë sasi karburanti për nevojat e bashkisë Fusheë Arrëz pra të një furnizimi prej 12 muajsh më parë lind dyshimi i arsyshëm i mungesës së cilësis dhe parametrave të kërkuar.

Konkluzion.

OE D... Sh.P.K nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin, pasi OE nuk plotëson kriteret e vendosura në DST.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, O. C., Kryetar, S. Ll. dhe A.D., Anëtar

Titulli i gjetjes: Kualifikim i pa drejt

Situata: Nga auditimi I procedurës së prokurimit me objekt "Blerje karburanti Diesel për nevojat e bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2022", me fond limit 6,720,000 lekë pa tvsh u konstatua se nga KVO e përbër nga O.Ç., A.D. dhe S.Ll. është kualifikuar OE "D..." ShPK me disa mangësi për sa i përket kriterëve për kualifikim.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik" VKM nr. 285 datë 19.05.2021."Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, nenet 82 pika 2.

Ndikimi: Mos e mallit/shërbimit në cilësi

Shkaku: Vlerësim i parregullt.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Bashkinë Fushë Arrëz, Komisioni I Vlerësimit të ofertave të marrin masa për kualifikimin vetëm të atyre OE që plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe në çdo rast për çdo paqartësi apo pasaktësi tërkojnë shpjegime shtesë nga OE pjesmarrës me qëllim përfitimin e punës/shërbimit apomallit me cilësinë dhe çmimin më të mirë.

5.Tenderi me objekt: "Mirëmbajtje në kanale vaditëse në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz" me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mirëmbajtje në kanale vaditëse në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 181, Datë 30/05/2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 181 dt. 30.05.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 26 dt. 21.05.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur e thjeshtuar	1. J.P. 2. T.P. 3. A. I.	1. O. Ç. – (Kryetar) 2. A. D. – (Anëtar) 3. S.Ll.– (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,606,666 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) BOE "A..." dhe "A...", Sh.P.K, me ofertë 1,590,392 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 16,274 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.06.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 BOE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 BOE
11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 2009, datë 05.07.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 1,908,470 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 30 ditë	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

Preventivi

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së mësipërme dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit publik, rezulton se shërbimi i projektimit të punimeve në këtë procedurë nuk është prokuruar nga Bashkia Fushë Arrëz.

-Preventivi i punimeve është hartuar nga NJP, duke u bazuar në kërkesat e bëra nga Administratorët e NJA-ve Iballë, Fierzë, Blerim dhe Qafë Mali. Zëri i punimeve është "gërmim kanali me krah tokë e butë", gjithësej 2,590.9 m³ gërmim dhe çmimi 620 lekë/është marrë nga

manuali teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. Gjithësej vlera e punimeve është 1,606,346 lekë pa TVSH. Përlllogaritja e fondit limit është dokumentuar me dokumentin, datë 15.04.2022, mbajtur nga NJP.

-Sipas zërit të punimeve, kemi të bëjmë me punime ndërtimi, por në dosjen e procedurës së mësipërme, nuk administrohet projekti teknik, relacioni, plan-vendosja e kanaleve vaditëse, distancat e kanaleve, grafiku i punimeve, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 5 në Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, nenin 15 në VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, J. P., T. P. dhe A. I.

Mbi përcaktimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 15.04.2022 të mbajtur nga NJP për argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit.

Pika 2.2.1 Në lidhje me kapacitetin ekonomik NJP kërkon: Kopje te vertetua te bilancit, te konfirmuara me vule prane autoritetit perkates (Adminstrates Tatimore) per vitin 2020. Ndërkohë në nenin 55 pika 4 e VKM 285 DATë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shprehet se: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë

Pika 2.3.1 - Në lidhje me përvojën e mëparshme të ofertuesit, kërkohet pune te ngjashme deri ne 20% te fondit limit qe prokurohet per nje vit te realizuar ne 5 vitet e fundit ose 100% e fondit limit te realizuar për këto vite. – Ndërkohë në nenin 41 pika 3 e VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktimi për të vërtetuar përvojën e mëparshme është: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% *(për procedurat e hapura të thjeshtuara) të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Siç vihet re NJP ka kërkuar përvoja të mëparshme të realizuara në 5 vitet e fundit në kundërshtim me kërkesat e VKM si dhe ka kërkuar “punë të ngjashme deri në 20% të fondit”, në interpretim të përcaktimeve ligjore shprehet qartë se :Ak nuk mund të kërkojë punë të ngjashme në DST më të madhe se 40% e fondit limit por në asnjë rast nuk shprehet se nëse OE paraqet kontrata me vlerë më të madhe se 40% për të argumentuar eksperiencën e mëparshme skualifikohet, më rastin e kërkesave të vendosura nga NJP “punë të ngjashme deri në 20% të fondit” ky kriter përjashton OE potencial. Gjithashtu nga NJP është përzgjedhur natyra e kontratës e klasifikuar “shërbime” ndërkohë që për eksperiencë të mëparshme NJP kërkon “Punë” cka tregon përzgjedhjen gabim të natyrës së kontratës edhe pse zërat e preventivit konsistojnë në punë.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, J. P., T. P. dhe A. I.

Pika 2.3.3 - AK kërkon që OE të ketë licencat N.P-1/A, N.P-7/A – ndërkohë që licenca e kategorisë N.P-7/A sipas përkufizimit të saj përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Sipas preventivit të punimeve, nuk rezulton të ketë asnjë punim tjetër përveç gërmimit, që ezaurohet nëpërmjet licencës N.P-1/A.

Pika - 2.3.4 - AK kërkon që për personelin dhe fuqinë punëtore Kandidati/ofertues a-Teknik i mesem ndertimi/topograf pjese e stafit teknik te shoqerise me deshmi kualifikim, kontrate pune. b-Vegla pune dore (kazma dhe lopata) cop (30+30).

c-Jelek identifikues cop 30

d-Punetori e thjeshte 20(njezet).

Totali i punonjesve te kerkuar duhet 21 (njezet e nje).

Numri i punonjsve të kërkuar Nuk argumentohet me analizë sipas zërave të punimeve, grafikut, pra sa kohë do të zgjasin punimet e gërmimit, mbushjes etj, si do të organizohet puna me 1 turn apo më tepër dhe sa punonjës do të angazhohen për këtë zë punimi, duke arritur në përfundimin se duhet ky numër punonjësish.

Gjithashtu nuk argumentohet nëse këto punonjës janë sipas natyrës së kontratës të rregjistruar në listpagesën e OE në referenc të VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp), të rishikuar” .

Pika 2.3.5 - Subjekti fitues duhet që të hartojë dosjen e zbatimit, librezën e masave për objektin pa të cilën nuk merret në dorëzim nga Bashkia Fushë-Arrëz – Ky kriter është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 7 dhe nenin 12 në Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pasi në asnjë rast sipërmarrësi i punimeve (oe shpallur fitues) nuk mund të jetë mbikëqyrës i punimeve dhe/ose kolaudator i punimeve. Institucioni ka detyrimin që të caktojë mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, nëpërmjet procedurës së prokurimit, duke lidhur kontratë shërbimi.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në **nenin 49**, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” , VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 41 dhe 55 “... *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik*”.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, J.P., T. P. dhe A.I.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në hartimin e kriterëve

Situata: Nga auditimi I procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje në kanale vaditëse në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,606,666 lekë pa tvsh u konstatua se nga NJP e përbër nga J.P., T.P. dhe A.I. kriteret e vendosura për kualifikim nuk janë në harmoni me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe jo në përputhje me kuadrin ligjorë dhe rregullatorë në fuqi.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenet 41 dhe 55 pika.

Ndikimi: Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vlerësim i parregullt mbi llojin dhe sasinë e punës/shërbimit që kërkohet të prokurohet nga ana e njësisë së prokurimit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Vlerësimi i ofertave.

KVO është ngritur me urdhër nr.26, datë 21.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga z. O.Ç., Kryetar, z. A.D. dhe z. S. Ll., Anëtar.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 90 dhe VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 80 dhe 82 .

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 BOE përkatësisht:

BOE “A...” Sh.P.K dhe “A...” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 1,590,392 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit 16,274 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimin të ofertës konstatohet se:

-Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin SPE dhe atij fizik të ndodhur në dosje u konstatua se OE A. pjesë e BOE së mësipërm në masën 25% të kontratës në listapagesat e paraqitura nuk plotëson kriterin 2.3.4 pika b) d-Punetori e thjeshte 20(njezet) në sasin 5 punonjës pasi: punonjësit që ky OE disponon në listapegsa (*mars 2022 e fundit e dorzuar nga subjekti*) sipas VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp), të rishikuar” janë të profesionit si mëposhtë:

M. B. me kod rregjistrimi ne listpagesa 7131.07 Bojaxhi për ndërtesa

L. C. me kod rregjistrimi ne listpagesa 9622.01 Punëtor krahu

S. Z. me kod rregjistrimi ne listpagesa 1120.01 Drejtor ekzekutiv në aktivitete ndërtimi,

N.M.me kod rregjistrimi ne listpagesa 9622.01 Punëtor krahu

M. Gj. me kod rregjistrimi ne listpagesa 9622.01 Punëtor krahu

M. U.me kod rregjistrimi ne listpagesa 9622.01 Punëtor krahu

A.P. me kod rregjistrimi ne listpagesa 5329.03 Sanitar

Sic edhe mund të shikohet qartë vetëm 4 punonjës janë të rregjistruar sipas kërkesave të DST. Gjithashtu edhe punonjësi që sipas kontratës është inxhirier në listpagesa është rregjistruar si Bojaxhi duke shmangur detyrimet ligjore sipas profesionit që i përket.

Konkluzion.

OE A... Sh.P.K, pjesë e BOE “A...” Sh.P.K dhe “A...” Sh.P.K, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin, pasi të gjithë OE nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, z. O. Ç., Kryetar, z. A. D. dhe z. S.Ll., Anëtar.

Titulli i gjetjes: Kualifikim i pa drejt

Situata: Nga auditimi I procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje në kanale vaditëse në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,606,666 lekë pa tvsh u konstatua se nga KVO e përbër nga O. Ç., A.D. dhe s. Ll. është kualifikuar BOE “A...” Sh.P.K dhe “A...” Sh.P.K me disa mangësi për sa i përket kriterëve për kualifikim.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenet 82 pika 2.

Ndikimi: Mos e mallit/shërbimit në cilësi

Shkaku: Vlerësim i parregullt.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Bashkinë Fushë Arrëz, Komisioni I Vlerësimin të ofertave të marrin masa për kualifikimin vetëm të atyre OE që plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe në çdo rast për çdo paqartësi apo pasaktësi tërkojnë shpjegime shtesë nga OE pjesmarrës me qëllim përfitimin e punës/shërbimit apomallit me cilësinë dhe çmimin më të mirë.

6.Tenderi me objekt: “Blerje Autobot Uji për Bashkinë Fushë-Arrëz” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Autobot Uji për Bashkinë Fushë-Arrëz”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 161, Datë 10/05/2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 161 dt. 10.05.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 26 dt. 21.05.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur e thjeshtuar	1. J. P. 2. T.P. 3. A.I.	1. O. Ç. – (Kryetar) 2. A.D. – (Anëtar) 3. S.LI. – (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 3,333,333 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE “O...”, Sh.P.K, me ofertë 3,298,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 53,333 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 24.05.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP–s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1956, datë 30.06.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 3,957,600 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 20 ditë	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

Preventivi

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së mësipërme dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik, rezulton:

-Nëdosjen e prokurimit nuk administrohet dokumentacioni i përlogaritjes së fondit limit , mënyra dhe vlera e tij vetëm shprehet nga NJP në dokumentin datë 06.05.2022 përcaktojmë si fond limit vlerën prej 3,333,333 lekë. Gjithashtu në dosje nuk administrohet përcaktimi i specifikimeve teknike të hartuara në DST si mëposhtë:

Specifikimet	Teknikete	Mjetit
Lloji		Mjet për furnizim me uje te Zjarrefikeses
Kategoria		Kamion lloji tip Autobotuji
Numri i akseve		2 (dy)
Karburanti		Naftë
Vitii prodhimit		1998 e sipër
Lartësia e diferencialitngakuota 0 (mm)		300 e lart
Rezervuari (materiali)		Inox
Autoboti (kapaciteti) litra		11500 e lart

Specifikimi i Materialeve:

- ~ Pompë për vetë-mbushëse e montuar ne mjet dhe me komandim prej sistemit te tij.
- ~ Pompë për shkarkim te ujit te montuar ne mjet dhe me komandim prej sistemit te tij.
- ~ Mjeti motorrik dhe boti i ujit duhet te jene te montuar fabrikisht.
- ~ Tub 50-100ml rrezerve.
- ~ Rezervuari i seksionit rrethor ose drejte kendor me thyerje ne kulme
- ~ Mbulesat ë brendshme me kundër rrëshqitje.
- ~ Treguesi i nivelit te ujit vizual ose me mates.
- ~ Shperndarje uji ne tre anet te mjetit.
- ~ Te jete i pajisur me bllokazh diferenciali.
- ~ Mjeti duhet i pajisur me jastik ajri.
- ~ E pajisur me shkallë në pjesë anësore ose fundore,prej çeliku.
- ~ Me kapak hermetik ne pjesen e siperme te rezervuarit.

- ~ Mjeti te jete i pershtateshem edhe per levizje ne terrene te thyera.
- ~ Mjeti te jete pajisur me sinjalistike fosforishente.
- ~ Mjeti i pajisur me sirene alarmi.
- ~ Mjeti duhet te kete shenja dalluesi te njejta me mjetet qe bashkia ka ne dispozicion per sherbimin Zjarrfikes.
- ~ Gabina e mjetit te kete tre vende bashke me drejtuesin e saj.
- ~ Mjeti duhet te kete nje garanci prej nje vit inga data e sjelljes se tij dhe marrjes ne dorezim nga komisioni i pritjes se mallit.
- ~ Mjeti te jete i pajisur me targa, me taksa vjetore dhe siguracion per 12 muaj nga data e dorezimit dhe duhet qe ne momentin e dorezimit mjeti te jete ne pronesi te bashkise Fushe-Arrez.
- ~ Para marrjes ne dorezim do te provohen per funksionalitetin e tyre te gjthe agregatet.
 - ~ Operatori ekonomik duhet qe garantoje qe gjate periudhes se garancise te riparoje çdo defekt te mjetit dhe sidomos
 - ~ F.V Filtër vaji
 - ~ F.V Filtër ajri
 - ~ F.V. Filtër nafte
 - ~ Vaj motori
 - ~ Sherbime ne motorr dhe kambio.
 - ~ Operatori ekonomik nuk mban pergjegjesi per defekte si demtime te gabines, çarje te gomave dhe djegie te motori nga pakujdesia e drejtuesit te mjetit.

Nga auditimi i këtyre specifikimeve të administruara në DST e procedurës dhe jo në dosjen e saj nuk gjen aspak argumentim dhe justifikim përzgjedhja e depozitës së ujit me material INOX element i cili rrit vleren e objektit të procedurës si dhe disa nga elementet e tjerë si: *Mjeti duhet te kete shenja dalluesi te njejta me mjetet qe bashkia ka ne dispozicion per sherbimin Zjarrfikes.*

Element tejet e specifik pasi OE që merr pjesë duhet të ket informacion të qartë për mjetet që AK disponon.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 36, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 2 dhe 76 “... 2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet. -Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, J. P., T. P.dhe A. I.

Pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Nga adutimi i DST nuk rezulton të jetë e kërkuar ndonjë vërtetim Xhiro sipas kërkesave të në nenin 55 pika 4 e VKM 285 DATë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shprehet se: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, J. P., T. P. dhe A. I.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në hartimin e kritereve dhe fondit limit

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Autobot Uji për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 3,333,333 lekë pa tvsh u konstatua se nga NJP e përbër nga J. P., T. P. dhe A.I. kriteret e vendosura për kualifikim nuk janë në harmoni me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe jo në përputhje me kuadrin ligjorë dhe rregullatorë në fuqi.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenet 2 , 41, 55 dhe 76.

Ndikimi: Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vlerësim i parregullt mbi llojin dhe sasinë e punës/shërbimit që kërkohet të prokurimet nga ana e njësive të prokurimit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Vlerësimi i ofertave.

KVO është ngritur me urdhër nr. , datë 21.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga z. O. Ç., Kryetar, z. A.D. dhe z. S. Ll., Anëtar.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 90 dhe VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 80 dhe 82 .

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE përkatësisht:

OE pjesmarrë “O...” Sh.P.K ka dërguar ofertën sipas kërkesave të DST me vlerë prej 3,298,000 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit 53,333 lekë.

Kontrata mes palëve është nënshkruar më 30.06.2022 me numër 1956 protokoll dhe afati i lëvrimit të këtij produkti është 20 ditë. Furnizimi i autobotit është realizuar më datë 26.07.2022 sipas dokumentacion dhe nga AK është përlogaritur dhe mbajtur penaltiteti në vlerën prej 94,040 lekë nga nënshkrimi i kontratës.

Edhe pse sigurimi i kontratës është paraqitur më datë 10.06.2022 nga AK titullari i saj shikohet një neglizhenc në lidhjen e kontratës, duke sjellë dhe një dyshim në dhëien e mundësis të furnizimit në kohë të Autobotit.

7.Tenderi me objekt: -“Sistemim, asfaltim, ndriçim rruga urbane "Rinia" Qyteti Fushe-Arrez me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: -“Sistemim, asfaltim, ndriçim rruga urbane "Rinia" Qyteti Fushe-Arrez		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 440, Datë 29/9/2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 440 dt. 22.09.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 26 dt. 21.10.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur	1. J. P. 2. T. P. 3. A. I.	1. O.Ç. – (Kryetar) 2. A.D. – (Anëtar) 3. S.Ll. – (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 12,540,545 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE “R...” me ofertë 11,497,684 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 1,042,861 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 27.10.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Grandi i qeverisjes qendrore	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 1OE, c) Kualifikuar 2 BOE
11. Ankimime AK-s’ka; APP–s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 2009, datë 14.12.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 13,797,220.80 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 6 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

Preventivi

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së mësipërme dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit publik, rezulton se shërbimi i projektimit të punimeve në këtë procedurë është kryer nga BOE H..." duke përcaktuar fondin limit prej 12,540,545 lekë si dhe volumet e punës.

Mbi këtë preventiv NJP ka hartuar procesverbalin nr. 3706/1 prot datë 22.09.2022.

Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 21.09.2022 të mbajtur nga NJP për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Pika 2.3.2 Në lidhje me kapacitetin ekonomik NJP kërkon: **2.3.2 Operatori ekonomik per realizimin e kontrates duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e meposhtem:**

- Eskavator me zinxhir/goma cop 1
- Kamion veteshkarkues 12 ton e lart cop 2
- Kamion veteshkarkues 30 ton e lart cop 2
- Komionçine 1.5 ton e lart cop 1
- Autobetoniere 4m3 e lart cop 1
- Betonjere dore 0.25 m3 cop 1
- Rrul i zakonshem 10 t cop 1
- Rrul cat cop 1
- Grejder cop 1
- Asfalto shtruese cop1
- Betoforma druri 100m2
- Vibrator betoni elektrik/djegje te brendshme cop 1
- Motogjenerator me djegje te brendshme cop 1
- Freksibel cop 1
- Hekur kthyes mekanike/hidraulike cop 1
- Karroca dore cop 2
- Lopata dhe kazma 3+3
- Mjete mbrojtese dhe identifikuese(kapele, jelek)cop35

Vëndosja e e kriterëve për disponimin e 2 kamionëve mbi 12 ton dhe e dy kamioneve mbi 30 është një kërkes tejet e ekzagjeruar për një rrugë me një gjatësi rreth 360 ml rrugë për tu zhvilluar, përmirësuar dhë ndërtuar.

Pika 2.3.4 Operatori ekonomik per realizimin e kontrates duhet te disponoje punonjes/specialist, manovrator, drejtues mjetesh si me poshte:

- Hekur kthyes 2.
- Plaka shtrues 2.
- Elektriçist 2.
- Montues tubo kanalizimi 1.
- Punetore betoni 2
- Karpentier (punetor armature) 2.
- Punetor asfalti 4.
- Manovrator 4.
- Drejtues mjetesh 3.

Vëndosja e e kriterëve për disponimin e 2 kamionëve mbi 12 ton dhe e dy kamioneve mbi 30 është një kërkes tejet e ekzagjeruar për një rrugë me një gjatësi rreth 360 ml rrugë për tu zhvilluar, përmirësuar dhë ndërtuar.

2.3.5 Operatori ekonomik per realizimin e kontrates duhet te paraqese edhe licencat e profesionale te shoqerise te vlefshme te leshuara nga organet kopetente sipas ketyre kategorive:

NP-1/A, NP-4/A, NP-11/A, NS-18/A.

NP-1/A Punime gërmimi në tokë

NP-4/A Rrugë autostrada mbikalime etj

NP-11/A Ndertime per N/stacionet, abinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shpërndarje e energjisë.

NS-18/A Punime Topogjoedezike

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në **nenin 49**, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 41 dhe 55 “... *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik*”.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, J. P., T. P.dhe A. I.

Vlerësimi i ofertave.

KVO është ngritur me urdhër nr.26, datë 21.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga z. O. Ç., Kryetar, z. A. D.dhe z. S.Ll., Anëtar.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 90 dhe VKM 285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 80 dhe 82 .

Në këtë tender ka marrë pjesë 3 OE përkatësisht:

1-“R...” me ofert ekonomike 11,497,684 lekë pa TVSH

2-“B...” shpk dhe ofert ekonomike 11,502,873,.66 lekë pa TVSH

3-“P. G.” me ofert ekonomike 12,165,050 lekë pa TVSH

Nga vlerësimi i ofertave janë kualifikuar në përmbushje të kërkesave të DST OE “R...” me dokumentacion sipas DST dhe me ofert ekonomike 11,497,684 lekë pa TVSH dhe “B...” shpk me ofert ekonomike 11,502,873,.66 lekë pa TVSH ndërsa OE “P...” është skualifikuar për munges dokumentacioni.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në hartimin e kriterëve dhe fondit limit

Situata: Nga auditimi I procedurës së prokurimit me objekt “Sistemim, asfaltim, ndriçim rruga urbane "Rinia" Qyteti Fushe-Arrez”, me fond limit 12,540,545 lekë lekë pa tvsh u konstatua se nga NJP e përbër nga J.P., T.P. dhe A. I. kriteret e vendosura për kualifikim nuk janë në harmoni me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe jo në përputhje me kuadrin ligjorë dhe rregullatorë në fuqi.

Kriteri: Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik” VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenet 2 , 41, 55 dhe 76.

Ndikimi: Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vlerësim i parregullt mbi llojin dhe sasinë e punës/shërbimit qe kërkohet te prokurohet nga ana e njësisë se prokurimit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

II.2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në zbatim të pikës “5”, të programit të auditimit Nr. 871/1, datë 10.10.2023, u auditua Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ndjekja e procedurave në zbatim të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

U shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;

2.5.1. Auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Plani i detajuar vendor

a--Leja në emër të zhvilluesit “B...” Shpk me objekt ndërtimi, KUL -Faza e Parë mbi Dambën e Vjetër të Sterileve pranë Fabrikës së Pasurimit Bakrit Fushe Arrëz

-Me shkresën me nr.prot. 1435 datë 17.05.2022 Bashkia Fushë-Arrëz ka dhënë lejen e infrastrukturës në mbështetje të nenëve 27,29 dhe 39 të ligjit me nr.107/2014 firmosur nga ish Kryetari i Bashkisë F.T.

-Me shkresën nr. 2946/14 datë, 25.05.2011 me nr identifikues 207 dhe vendimi me nr.19 i KSHK është miratuar leja mjedisore për subjektin “B.” Sh.a.

-Me shkresën nr.3 prot, datë 28.03.2022 është dhënë nga Bashkia Fushë Arrëz leja e zhvillimit, si dhe dokumentacioni teknik i raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis për zgjerimin e sipërfaqes së dambës, depozitimeve të sterileve të fabrikës së pasurimit të bakrit në Fushe Arrëz e **vitit 2013**.

-Me shkresën me nr.1087/1, datë 22.04.2022 njoftohet subjekti “B.” për vlerësim pozitiv të projektit dhe pagesë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Mbi auditimin e lejeve të ndërtimit

-Për periudhën objekt auditimi (viti 2022) është miratuar vetëm 1 leje ndërtimi, nga të cilat 1 leje për infrastrukturë, ***Ndërtimi i KUL -Faza e Parë mbi Dambën e Vjetër të Sterileve pranë Fabrikës së Pasurimit Bakrit Fushe Arrëz*** me vlerë investimi 36,792,011 lekë, dorëzuar elektronikisht më datë 11/04/2022, me numër aplikimi AN110420220041, nr. prot.1087, datë 13/04/2022, Bashkia Fushë- Arrëz. Të ardhurat e Bashkisë Fushë Arrëz nga TNI për këtë leje janë në vlerën 911,955 lekë përlllogaritja e së cilës është bërë në përputhje me pikën 1 dhe 2 të nenit 46 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”

► **Titulli i gjetjes:** Miratimi i 1 leje ndërtimi pa dokumentat që duhet të paraqesë zhvilluesi si dhe pa bashkëveprimin e institucioneve të tjera që përfshihen në miratimin e lejeve.

Situata: 1 Sipas regjistrimit elektronik në emër të zhvilluesit “B...” shpk, me datë aplikimi 11.4.2022, me nr. çështje në sistemin e lejeve AN110420220041, për objektin: “Ndërtimi i KUL -Faza e Parë mbi Dambën e Vjetër të Sterileve pranë Fabrikës së Pasurimit Bakrit Fushe Arrëz

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

a.- Subjekti aplikues, nuk ka paraqitur mendim nga asnjë prej institucioneve të nevojshme për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe konkretisht:

-Mungon Vendimi për Ndikimin në mjedis të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Por dokumentacioni teknik i raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis është i vitit 2011. Nuk ka raport dhe as mendim bashkëlidhur. Mungon kërkesa dhe mendimi nga Ujësjellës Kanalizime. --Mungon kërkesa dhe mendimi nga OSHEE. Mungon kërkesa dhe mendimi nga ASHK. Mungon konfirmim nga Ministria e Linjës.

b- Plani i rehabilitimit dhe ai i rilevimit në lejen e zhvillimit të vitit 2022 janë të viteve 2009.

-Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21,të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar i cili përcakton se:

6. Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve. Me dërgimin e kërkesës pezullohet llogaritja e afatit të shqyrtimit të aplikimit, sipas pikës 4, të këtij neni, deri në dhënien e mendimit/miratimit përkatës. Në mungesë të përgjigjes së autoriteteve publike nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, brenda 10 ditëve pune, kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje dhe autoriteti përgjegjës i zhvillimit ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për leje.

.c-Në lejen e zhvillimit mungojnë:

1-dokumenti që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën;

2) planin e riveimit të pronës, në shkallë **1:500**, nga topograf i licencuar;

3) projekt-idenë arkitektonike të zhvillimit;

4) kopje të licencës së topografit dhe projektuesit, sipas shkronjave “ç” dh “d”;

-Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar i cili përcakton se:

Dokumentet e vetme që duhet të paraqesë pronari ose zhvilluesi për t’u pajisur me leje zhvillimi janë: a) kërkesa për leje, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në këtë rregullore dhe në sistemin elektronik të lejeve; b) prokura ose autorizimi, në emër të personit fizik apo juridik, në rast se kërkesa paraqitet nga një përfaqësues i pronarit ose zhvilluesit; c) dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën; ç) planin e riveimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar; d) projektidenë arkitektonike të zhvillimit; dh) kopje të licencës së topografit dhe projektuesit, sipas shkronjave “ç” dh “d”.

Kriteri: Trajtuar tek situata e gjetjes.

Shkaku: Neglizhencë e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Fushë Arrëz.

Ndikimi/Efekt: Miratimi i lejeve të ndërtimit me mungesë dokumentacioni si dhe pa bashkëveprimin e institucioneve të tjera që përfshihen në miratimin e lejeve, pa ju nënshtruar vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, ku dokumentacioni që kërkohet të jetë bazuar në referencat përkatëse të miratura, si dhe të bashkerendohet puna me të gjitha institucionet tjera publike brenda kompetencave që u njeh ligji, duke përfshirë dhe kërkesën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si dhe Institucioneve të tjera me të bazuar sërish në VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor” i ndryshuar.

III.2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, për periudhën 01.01.2022 -31.12.2022, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), nuk është ngritur dhe nuk funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Për vitin 2022, sipas strukturës të miratuar me urdhrin nr. 459, datë 13.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, të Njësive Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2022” është përcaktuar një pozicion pune si inspektor i mbrojtjes së territorit, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve, pranë Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Investimeve. Sa më sipër, përgjatë vitit nuk është konstatuar asnjë ndërtim pa leje.

-Sa më sipër, nga ky Sektor, nuk disponohet asnjë procedurë, apo akt mbi të cilin të pasqyrohet objekti i aktivitetit për vitin 2022, duke mos dhënë asnjë garanci për mbrojtjen dhe kontrollin e territorit nga ndërtimet pa leje, apo për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë së objekteve të pajisura me leje ndërtimi.

Nga verifikimi, dhe nisur nga rekomandimet e mëparshme të KLSH, në vitin 2023, sipas strukturës të miratuar me urdhrin nr.313, datë 08.08.2023, shtesë dhe ndryshim i urdhërit nr.596 datë 19.12.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, të Njësite Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2022”, Bashkia Fushë-Arrëz ka krijuar Sektorin e IMTV, me dy pozicione pune, si Përgjegjës Sektori të IMTV me urdhër nr.419 datë 05.10.2023, si dhe Inspektor Sektori IMTV me urdhër nr.420 datë 05.10.2023.

Sa më sipër, në Bashkinë Fushë-Arrëz, mbas lënies të rekomandimeve të KLSH, struktura drejtuese e Bashkisë Fushë-Arrëz ka përmbushur detyrimet e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, duke ngritur strukturën e IMTV.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për vënien në funksion të plotë të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

III.2.7.Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

2.7.1. Në zbatim të pikës 8 të Projekt Raportit të Auditimit “*Të ndryshme të dala gjatë auditimit*”, u auditua ankesa e administruar në KLSH me numër 798 prot. Datë 19.09.2023 si dhe marrë shkas nga kjo ankesë edhe largimet dhe rekrutimet e reja pranë Bashkisë Fushë Arrëz.

Për periudhë objekt auditimit në Bashkinë Fushë – Arrëz janë evidentuar lëvizje të shumta të punonjësve si në ardhje ashtu dhe në largim, mar shkas nga ankesa e administruar në KLSH me nr. 798 prot datë 19.09.2023 dhe nga këto lëvizje që në shumicën e rasteve largimet janë me dorëheqje dhe pranimet pa një procedurë të rregullt konform procedurave të rekrutimit bazuar në ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) u audituan lëvizjet e punonjësve pranë kësaj bashkie për periudhën 2022-30.09.2023.

Në Bashkinë Fushë Arrëz për periudhën objekt auditimi kemi 40 punonjës të larguar dhe 27 të rekrutuar ndërsa për vitin 2023 këto të dhëna paraqiten në nivelin 68 emërimet dhe 40 largime, nga emërimet 19 kanë ndodhur përgjatë 6 mujorit të parë dhe pjesa tjetër mbas 1.07.2023, pjesa e largimeve dhe rekrutimeve përgjatë fushatave elektorale mbetet përsëri problem në këtë Bashkia.

Gjithashtu nisur nga sa më sipër grupi i auditimit mori në shyrtime auditimit dosjet përkatëse të 7 prej punonjësve të kësaj Bashkie kryesisht në pozicione menaxhues drejtues, nëse në këto dosje administrohet dokumentacioni sipas kërkesave të VKM nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për mbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të rregjistrit qendror të personelit” lidhja 1 Pika 3 dokuementacioni që duhet të administrohet në dosje...:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- d) Lista e notave dhe nota mesatare
- e) Certifikata ose diploma e kualifikime të ndryshme
- f) Dëshmi mbrojtje gjuhe të huaj
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune

- i) Raport mjekoligjorë
etj
Gjithashtu çdo dosje personeli duhet të ket inventarin e saj.

T.Ll. në pozicion përgjegjës i stacionit zjarrfikës në dosje administrohen dokumentat si më poshtë:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- d) Lista e notave dhe nota mesatare
- e) Certifikata ose diploma e kualifikime të ndryshme
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune
- i) Raport mjekoligjorë

N. Q. në pozicion kryeinspektor i policisë bashkiake në dosje administrohen dokumentat si më poshtë:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- d) Lista e notave dhe nota mesatare
- e) Certifikata ose diploma e kualifikime të ndryshme
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune
- i) Raport mjekoligjorë

A.D. në pozicion përgjegjës i seksionit pyjorë në dosje administrohen dokumentat si më poshtë:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune
- i) Raport mjekoligjorë

J.P. në pozicion Specialiste prokurimesh në dosje administrohen dokumentat si më poshtë:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- d) Lista e notave dhe nota mesatare
- e) Certifikata ose diploma e kualifikime të ndryshme
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune
- i) Raport mjekoligjorë

S.M. në pozicion përgjegjës i sektorit të çështjeve sociale në dosje administrohen dokumentat si më poshtë:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- e) Certifikata ose diploma e kualifikime të ndryshme
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune

i) Raport mjekoligjorë

S. B. D. në pozicion përgjegjës i sektorit të auditit të brendshëm në dosje administrohen dokumentat si më poshtë:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- e) Certifikata ose diploma e kualifikime të ndryshme
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune
- i) Raport mjekoligjorë

K. C. në pozicion kordinatore e dhunës në familje dhe barazisë gjinore në dosje administrohen dokumentat si më poshtë:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- d) Lista e notave dhe nota mesatare
- e) Certifikata ose diploma e kualifikime të ndryshme
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune
- i) Raport mjekoligjorë

F. S. në pozicion përgjegjëse e sektorit të burimeve njerzore në dosje administrohen dokumentat si më poshtë:

- a) Fotokopje e ID
- b) Certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare
- c) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimorë që kërkon pozicioni i punës...
- d) Lista e notave dhe nota mesatare
- e) Certifikata ose diploma e kualifikime të ndryshme
- f) Dëshmi mbrojte gjuhe të huaj
- g) Akti i emërimit në pozicionin e punës
- h) Librez pune
- i) Raport mjekoligjorë

Nga auditimi i dosjes dhe stafit u konstatuan se politikat e kësaj bashkie për rekrutim stafi të ri janë tejet të aplikuara duke i dhen shkas brezit të ri të bëjnë zëvendësimin dhe të japin kontribut pranë kësaj bashkie por vlen të theksohet se: Rekrutimi është aktiviteti kryesor dhe më i rëndësishëm në të cilin gjen zbatim konkret qëllimi dhe ambicia e ligjit për “krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike”.

Mjeti kryesor i zgjedhur nga ligjvënësi për zbatuar parimet e mësipërme është konkurrimi i hapur, i cili është kthyer në procedurën e rregullt që ndiqet për plotësimin e pozicioneve vakante në shërbimin civil.

Mbetet e rëndësishme që ky proces i hapur konkurrimi të menaxhohet në mënyrë të tillë që jo vetëm të sigurohet niveli më i lartë i paanshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të të gjithë kandidatëve, por edhe të garantohet efënca e procesit të rekrutimit. Kjo qasje nënkupton që procedurat duhet të synojnë përzgjedhjen e kandidatëve më të aftë si edhe të shmangin vonesat për plotësimin e vendeve vakante.

Procesit të rekrutimit i është kushtuar vëmendje në rritje nga institucionet publike kryesore, ndaj standardet dhe rregullat e detajuara për zbatimin korrekt të tij janë përcaktuar në disa akte ligjore:

- Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, neni 18; kapitulli IV, V dhe VI;
- VKM nr. 118/2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TNDsë, i ndryshuar";
- Udhëzimi nr. 2 datë 27/03/2015, i Departamentit të Administratës Publike "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur";
- Udhëzimi nr. 6/2014, i Departamentit të Administratës Publike, "Për procesin e rekrutimit dhe të emërimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND", i ndryshuar.

Sa më sipër grupi i auditimit e vlerëson qasjen e treguar nga Bashkia Fushë Arrëz për rekrutimin e stafit të ri në moshë dhe përvojë por njëkohësisht kërkon pasjen kujdes në pozicionet e punës së ofruara kandidatëve pa eksperimentim në pozicione drejtuese apo menaxhuese, përvoja në administratën publike është një element shumë i rëndësishëm në një qeverisje të mirë qasje të drejtë me qytetarin dhe mirmenxhimin e fondeve publike për sa më lart mban përgjegjësi kryetari i Bashkisë H. C.

Titulli i Gjetjes: Mbi shqyrtimin e ankesës për vendosjen e stafit të ri në pozicione drejtuese
Situata: Për periudhë objekt auditimit në Bashkinë Fushë – Arrëz janë evidentuar lëvizje të shumta të punonjësve si në ardhje ashtu dhe në largim, mar shkas nga ankesa e administruar në KLSH me nr. 798 prot datë 19.09.2023 dhe nga këto lëvizje që në shumicën e rasteve largimet janë me dorëheqje dhe pranimet pa një procedurë të rregullt konform procedurave të rekrutimit bazuar në ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"(i ndryshuar) u audituan lëvizjet e punonjësve pranë kësaj bashkie për periudhën 2022-30.09.2023.

Në Bashkinë Fushë Arrëz për periudhën objekt auditimi kemi 40 punonjës të larguar dhe 27 të rekrutuar ndërsa për vitin 2023 këto të dhëna paraqiten në nivelin 68 emërime dhe 40 largime, nga emërimet 19 kanë ndodhur përgjatë 6 mujorit të parë dhe pjesa tjetër mbas 1.07.2023, pjesa e largimeve dhe rekrutimeve përgjatë fushatave elektorale mbetet përsëri problem në këtë Bashkia.

Kriteri: • Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, neni 18; kapitulli IV, V dhe VI; • VKM nr. 118/2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TNDsë, i ndryshuar"; • Udhëzimi nr. 2 datë 27/03/2015, i Departamentit të Administratës Publike "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur";

Ndikimi/Efekti: Krijimi i problematikave në menxhimin e burimeve njerzore

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe komisioni I pranimit të përhershëm në çdo rast të marrë masa për ndjekjen e procedurave të plota dhe të paanshme në plotësimin e vendeve vakante duke respektuar fazat e rekrutimit, publikimin e vendeve vakante dhe dhënine e mundësisë për ngritjen në detyrë e pastaj rekrutimin rishtaz të stafit të Bashkisë Fushë Arrëz.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A.MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e rakorduara me Degën e Thesarit, rezulton se buxheti përfundimtar në vlerën 364,176,920 lekë është realizuar në vlerën 300,318,887 lekë ose në masën 82%. Nga auditimi konstatohet se në mos realizimin e plotë të buxhetit kanë ndikuar mos realizimi shpenzimeve operative të cilat rezultojnë në masën 68% dhe mos realizimi i investimeve të cilat janë realizuar në masën 53%. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masa për korrigjime gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara sipas treguesve realë. Nga auditimi rezulton se rishikimi i buxhetit është bërë vetëm një herë gjatë vitit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Sektori i Financës, në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, si dhe të rishikuar përgjatë vitit, mbi bazë nevojash dhe mundësish realizimi, si për investimet ashtu edhe për shpenzimet për mallra e shërbime.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat rezulton se të ardhurat në Bashkinë Fushë Arrëz janë planifikuar në vlerën 28,555 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 20,697 mijë lekë ose në masën 72%, me një mos realizim në vlerën 7,858 mijë lekë. Mos realizimi i plotë i të ardhurave ka ardhur si pasojë e mos arkëtimit të taksave dhe tarifave kryesisht familjare, por edhe atyre të bizneseve dhe konkretisht zërat që paraqiten me nivel shumë të ulët realizimi janë taksa mbi tokën bujqësore realizuar vetëm 5%, taksa e ndikimit në infrastrukturë realizuar vetëm 16%, taksa e parkimit realizuar vetëm 4%, ndërkohë që nuk është arkëtuar taksa e hotelit dhe e rentës minerare. Krahas zërave me mos realizim, konstatohet se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka planifikuar të ardhura nga tarifatat për lejet e karburanteve, pavarësisht se në këtë Bashki operojnë të tilla, si dhe nga tatimi mbi të ardhurat personale 2%. Për sa më lart treguesi i realizimit të të ardhurave nuk është real. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një databazë të saktë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Pjesa më e madhe e zërave të të ardhurave parashikohen mbi baza historike dhe jo mbi të dhëna të sakta të numrit të familjeve apo bizneseve. Nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Po kështu edhe për rastet e bizneseve, Bashkia është mjaftuar me njoftimet shkresore për shlyerjen e detyrimeve dhe nuk është vijuar me masa të tjera. Si rezultat i të gjitha mangësive të mësipërme, për vitin 2022, në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz rezultojnë të ardhura të munguara në vlerën 3,572,456 lekë, për të cilat nuk është vijuar me marrjen e masave shtrënguese të arkëtimit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-33, të Raportit përfundimtarë të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, të marrin masa për ngritjen e një grupi pune për fillimin e identifikimit të të gjithë abonentëve familjarë dhe bizneseve, në koordinim me zyrën e Gjendjes Civile dhe çdo agjent tjetër tatimor të cilët kanë të dhëna për këto subjekte, në mënyrë që planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga kjo Bashki të jetë sa më real. Për këtë, nëse do të jetë e nevojshme, të kërkohet edhe ndihma dhe bashkëpunimi i grupeve të punës të cilët kanë realizuar censusin

në territorin e kësaj Bashkie. Të gjithë të dhënat të mbahen manualisht edhe në regjistrat fizikë, krahas atyre elektronikë.

Brenda vitit 2024

2.2 Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të marrin masa që për aq sa është e mundur të identifikohet, të filloje procedura e marrjes së masave shtrënguese për vjeljen e të ardhurave të munguara, nëpërmjet bllokimit të llogarive, kallëzimeve penale apo mënyrave të tjera që parashikon legjislacioni në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Fushë Arrëz dhe Njësitë Administrative nuk janë lëshuar autorizimet përkatës për ushtrimin e aktivitetit. Si pasojë e mos rakordimit nga zyra e Shërbimeve Publike, të 4 subjektet që operojnë në fushën e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre, nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar dhe rrjedhimisht të gjithë rezultojnë debitorë në vlerën totale **4,000,000 lekë**, veprime në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-33, të Raportit përfundimtarë të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Zyra e Shërbimeve Publike të marrë masa për pajisjen me autorizimet përkatëse të të gjithë subjekteve që operojnë në fushën e tregtimit të hidrokarbureve dhe pas plotësimit të dosjeve përkatëse me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të rakordojë me zyrën e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për përlllogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve nga pajisja me autorizime.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, është pjesërisht efektive, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët, si më poshtë vijon:

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Rregullorja e brendshme e Bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e Bashkisë. Në raste të caktuara, detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Për vitin 2022 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit.

-Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

-Për vitin 2022 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

-Nuk është krijuar regjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 9-12, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit

të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

4.2.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit Juridik në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

4.3.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të Bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Fushë Arrëz.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Fushë Arrëz përgjatë vitit 2022, u konstatua se:

Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk administrohet shkresa e ndryshimit të planit vjetor të auditimeve e miratuar nga titullari i institucionit dhe përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2022 të Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën “ç” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njesisë publike për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu në raportin vjetor të aktivitetit, kreu IV.3 “Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre” nuk përmban plotësisht informacion sipas përcaktimit të bërë në formatin standard nr.5 “Struktura e raportit vjetor të njësive të auditimit të brendshëm” në manualin e auditimit të brendshëm.

-Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit.

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 i Ministrisë së Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

-Për vitin 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete me risk të lartë që kryen Bashkia Fushë Arrëz, si Sektori i Financës, Sektori Juridik, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, prokurimet e realizuara nga Bashkia Fushë Arrëz, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 12-14, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njesisë vendore në arritjen e objektivave.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Fushë Arrëz për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 3,572,456 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën prej:

-3,572,456 lekë detyrimi nga subjektet private dhe debitorë për qiratë.

-99,859 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes dhe institucione.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ë”, pika 3, neni 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” në Udhëzimin e MF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 33-50, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 9,250,997 lekë, duke pasqyruar edhe kontrata të cilat i ka përfunduar afati i mbajtjes së garancisë . Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 33-30, të Raportit përfundimtarë të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia, është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatua se në Bashkinë Fushë Arrëz janë zhvilluar gjithsej 13 procedura prokurimi nga këto 1 procedurë e hapur dhe 12 procedura të hapur të thjeshtuara me vlerë të fondit limit prej 39,698,905 lekë nga këto janë audituar 7 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit prej 31,054,676 lekë ose 78% e fondit të prokuruar. Nga auditimi u konstatuan **4** raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj), si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në **3** raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar dhe dokumentuar mënyra e përllogaritjes së fondit limit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenet 2 , 41, 55 dhe 76. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 50-73, të Raportit përfundimtarë të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, Si dhe në çdo rast në përllogaritjen e fondit limit ti nënshtrohen njëerës nga mënyrat që parashikon ligji, si dhe për çdo rast të marrin masat për dokumentimin e tij me qëllim menjanimin e problematikave të krijuara dhe menaxhimin me efikasitet të fondeve publike.

Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburanti Diesel për nevojat e Bashkisë, Fushë-Arrëz për vitin 2022”, me fond limit 6,720,000 lekë pa TVSh u konstatua se nga KVO është kualifikuar OE “D...” ShPK, duke mos përmbushur kriteret për kualifikim, licencën aktive në qytetin e Fushe Arrëzit, raportin e analizave të mostrave etj, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 82 pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 50-73, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për kualifikimin vetëm të atyre OE që plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe në çdo rast për çdo paqartësi apo pasaktësi të kërojnë shpjegime shtesë nga OE pjesmarrës me qëllim përfitimin e punës/shërbimit apo mallit me cilësinë dhe çmimin më të mirë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacion mbi lëshimin e lejeve dërrtimit/zhvillimit nga DPZHKT Bashkia Fushë Arrëz, rezulton se:

Nga DPZHKT është lëshuar leje ndërtimi për subjektin zhvillues “B...” shpk me objekt “Ndërtim i KUL- Faza e Parë mbi Dambën e Vjetër të Sterileve pranë fabrikës së pasurimit të Bakrit Fushë Arrëz”, nga ku konstatohet se: subjekti aplikues, nuk ka paraqitur mendim nga asnjë prej institucioneve të nevojshme për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe konkretisht: -Mungon Vendimi për Ndikimin në Mjedis të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Dokumentacioni teknik i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është i vitit 2011. Nuk ka raport dhe as mendim bashkëlidhur. Mungon kërkesa dhe mendimi nga Ujësjellës Kanalizime. Mungon kërkesa dhe mendimi nga OSHEE. Mungon kërkesa dhe mendimi nga ASHK. Mungon konfirmim nga Ministria e Linjës.

- Plani i rehabilitimit dhe ai i rilevimit në lejen e zhvillimit të vitit 2022 janë të viteve 2009. Edhe pse me mangësitë e mësipërme, nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz nuk është ndërmarë asnjë hap si në sistemin e-leje për plotësim dokumentacioni, ashtu dhe më vonë duke e miratuar me mangësitë e sipërcituara, veprime në kundërshtim me nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-75, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)

10.1.Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Fushë Arrëz, të marra masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, ku të respektohet legjislacioni sektorial në fuqi, duke kryer bashkëveprimin me të gjitha institucionet e ngarkuara për dhënie mendimi, përpara miratimit të lejes.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për veprimtarinë e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezulton se në Bashkinë Fushë Arrëz për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), nuk është ngritur dhe nuk funksionon në bazë të nenit 4, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Për vitin 2022, sipas strukturës të miratuar me urdhrin nr. 459, datë 13.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, të Njësisë Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varësi të Bashkisë për vitin 2022” është përcaktuar një pozicion pune si inspektor i mbrojtjes së territorit, pjesë e Drejtorisë

së Shërbimeve, pranë Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Investimeve. Sa më sipër, përgjatë vitit nuk është konstatuar asnjë ndërtim pa leje.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 75, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Bashkia Fushë Arrëz në rekrutimin e stafit të ri dhe zëvendësimin e atij të larguar u konstatua se: për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Fushë – Arrëz janë evidentuar lëvizje të shumta të punonjësve si në ardhje ashtu dhe në largim, marrë shkas nga ankesa e administruar në KLSH me nr. 798 prot datë 19.09.2023. Largimet nga puna në shumicën e rasteve janë me dorëheqje, ndërsa pranimet pa një procedurë të rregullt konform procedurave të rekrutimit bazuar në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, neni 18; kapitulli IV, V dhe VI; • VKM nr. 118/2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND së, i ndryshuar”; • Udhëzimi nr. 2 datë 27/03/2015, i Departamentit të Administratës Publike "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 75-79, të Raportit përfundimtarë të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe komisioni i pranimit të përhershëm, në çdo rast të marrë masa për ndjekjen e procedurave të plota dhe të paanshme në plotësimin e vendeve vakante duke respektuar fazat e rekrutimit, publikimin e vendeve vakante dhe dhënien e mundësisë për ngritjen në detyrë e pastaj rekrutimin rishtaz të stafit të Bashkisë Fushë Arrëz.

Në vijimësi

B.1. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1.Gjetje nga auditimi Nga të dhënat rezulton se Bashkia Fushë Arrëz ka patur detyrime të prapambetura në fillim të vitit 2022 në vlerën 8,778,833 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime në vlerën 1,630,601 lekë dhe janë kryer pagesa në vlerën 5,024,849 lekë, duke mbartur një detyrim të prapambetur në fund të 2022 në vlerën 5,384,585 lekë. Nga auditimi rezulton se e gjithë vlera e detyrimeve të prapambetura përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore për largimet e pa drejta nga puna të punonjësve, si dhe nga vendimet gjyqësore mbi shkelje që lidhen me projektet e investimeve. Vetëm për vitin 2022 janë krijuar detyrime nga largimet e pa drejta nga puna në vlerën 1,630,601 lekë, të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41; Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-33, të Raportit përfundimtarë të Auditimit)

1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Njësinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për vlerësime dhe vendimmarrje korrekte në rastet e largimeve nga puna të

punonjësve, duke argumentuar në çdo rast shkeljet e konstatuara, si dhe ndjekjen me përpikmëri të çdo faze që parashikon kuadri ligjor përpara vendimmarrjes finale për shkarkimin e punonjësit.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje lëndë djegëse për ngrohje për vitin 2022” me fond limit 1,768,302 - lekë pa TVSh, u konstatua se NJP në përllogaritjen e fondit limit nuk ka respektuar format që parashikohet në legjislacion duke anashkaluar çmimet e miratuara në manualin e çmimeve të ndërtimit për produktin “dru zjarri” element që ka sjellë dhe rritjen e fondit limit. Gjithashtu nuk kanë dokumentuar mënyrën e përllogaritjes së fondit limit në kundërshtim me parashikimet ligjore, duke sjell një rritje të kostos për dru zjarri me vlerë 540,540 lekë më tepër, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pikat 1 dhe 4 të nenit 13 dhe pikën 2 të nenit 76. VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-33, të Raportit përfundimtarë të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa që në çdo rast në përllogaritjen e fondit limit ti nënshtrohen njëres nga mënyrat që parashikon ligji, si dhe për çdo rast të marrin masat për dokumentimin e tij me qëllim menjanimin e problematikave të krijuara dhe menaxhimin me efikasitet të fondeve publike.

Në vijimësi

B.2 MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1.Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimor 2022, ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 4,000,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-33, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Zyra e taksave dhe Tarifave vendore të marrë masa për ndjekjen e të gjithë detyrimeve sipas legjislacionit dhe paketave fiskale të miratura si dhe vjeljen e detyrimit të krijuar nga subjektet që tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Fushë Arrëz me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Fushë Arrëz, përllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe moveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 1,761,248 lekë kryesisht nga mos pagesa e detyrimeve kontraktuale.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Neni 35 në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 11 në nenin 2 në Kreun I në Ligjin nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010; Pikat 5 dhe 6 në Kreun I, shkronja

“c” në pikën 15, pika 4 në Kreun II, si dhe shkronja “c” në pikën 1 në Kreun III në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-33, të Raportit përfundimtarë të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me zyrën Juridike, të marrin masa që për aq sa është e mundur të identifikohet, të filloje procedura e marrjes së masave shtrënguese për vjeljen e të ardhurave të munguara, nëpërmjet parashikimeve ligjore në fuqi.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.